



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 685 Akti

Nr. 651 Vendimi
Tiranë, më 27.4.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko Kryesuese
Alma Faskaj Relatore
Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në Tiranë, në datën 27.4.2023, ora 12:45, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Urim Buci**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Urim Buci, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Urim Buci do të shqyrtohet nga trupi gjykues i përberë nga komisionerët Alma Faskaj relatores, Pamela Qirko kryesuese dhe Xhensila Pine anëtare.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Prokuroria e Përgjithshme¹.

4. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer kontroll të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Urim Buci, duke krahasuar deklaratën e pasurisë të rivlerësimit kalimtar *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga vetë subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja për subjektin e rivlerësimit Urim Buci ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

6. Për këtë qëllim, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Urim Buci (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2022, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Urim Buci.

7. Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura

¹ Raport i hartuar në datën 19.19.2018.

sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

8. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, të trupit gjykues nr. 4, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

9. Në datën 7.1.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 9.1.2021 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

10. Në datën 6.4.2023, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Urim Buci, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

11. Po në të njëjtën datë, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë deri në orën 9:00 të datës 20.4.2023.

12. Në datën 12.4.2023, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes.

13. Në datën 19.4.2023, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruar me dokumentacion.

14. Në datën 20.4.2023, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Urim Buci në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 25.4.2023, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), Tiranë.

15. Në datën 25.4.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Urim Buci u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

17. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Urim Buci shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Z. Urim Buci ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit,

sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

25. Por, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërinë e burimit dhe të krijimit të saj.

28. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Urim Buci.

29. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

30. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2015 – 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit Urim Buci e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur) në datën 26.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

32. Subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka ushtruar këto detyra:

- a) në vitet 2005 – 2015 oficer i policisë gjyqësore;
- b) nëntor 2015 e në vazhdim, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër².

33. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Tokë arë (dy pasuri)

a) Tokë arë me sipërfaqe 724 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, K., Tiranë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi: “*Faktikisht, kjo sipërfaqe disponohet nga unë deklaruesi dhe vëllai im D.B. Secili nga ne zotëron 50% të kësaj sipërfaqeje*”.

Burimi i krijimit: “*Të ardhura këto të siguruar nga emigracioni, përkatësisht unë deklaruesi në Angli (2000 – 2004) dhe vëllai D.B në Greqi (1991 – 2012)*”.

Vlera: 200,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 26.7.2007, me noter R.K, Tiranë.

² Pas emërimit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër është komanduar për periudha të caktuara në prokuroritë e rretheve Vlorë dhe Kurbin.

Pjesa takuese: 100%.

b) Tokë arë me sipërfaqe 276 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, K., Tiranë. Subjekti i rivlerësimit deklaron: “*Faktikisht, kjo sipërfaqe disponohet nga unë deklaruuesi dhe vëllai im D.B. Secili nga ne zotëron 50% të kësaj sipërfaqeje*”.

Burimi i krijimit: “*Të ardhura këto të siguruara nga emigracioni, përkatësisht unë deklaruuesi në Angli dhe vëllai në Greqi*”.

Vlera: 200,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 26.7.2007, me noter R.K, Tiranë.

Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

1.1 Sipas certifikatave për vërtetim pronësie, këto pasuri janë regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit Urim H. Buci³ me nr. pasurie *** dhe ***, z. k. ***.

1.2 Të dyja këto pasuri subjekti i ka blerë në datën 26.7.2007, kundrejt vlerës 200,000 lekë⁴ dhe certifikatat e pronësisë janë lëshuar në datën 27.8.2007, pra para fillimit të detyrës nga subjekti.

1.3 Z. Urim Buci dhe vëllai i tij D.B kanë deklaruar para noterit⁵ se këto pasuri i kanë blerë së bashku, por dokumentacioni i pronësisë është në emër të subjektit, pasi në kohën e plotësimit të dokumentacionit vëllai i subjektit ka qenë në emigracion. Kanë deklaruar se të ardhurat për blerjen e këtyre pronave janë nga kursimet e tyre nga emigracioni dhe secili prej tyre është pronar me ½ pjesë në këto pasuri dhe se mbi këto pasuri vëllai i subjektit ka ndërtuar objektin 2-katësh në proces legalizimi.

1.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, në deklaratën *Vetting*, subjekti shpjegon se kanë shërbyer: “*Të ardhura këto të siguruara nga emigracioni, përkatësisht unë deklaruuesi në Angli (2000 – 2004) dhe vëllai D.B në Greqi (1991 – 2012)*”. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti paraqiti: kopje të lejes për punë për personin tjetër të lidhur, shtetasin D.B, për periudhën 23.6.2000 - 22.6.2001; kopje të një prej faqeve të librit të shëndetit për periudhën 1.3.2008 - 28.2.2009.

1.5 Subjekti nuk përcolli dokumentacion provues as për vlerën e të ardhurave të fituara nga personi tjetër i lidhur, z. D.B, dhe as për vlerën e të ardhurave të fituara prej tij (prej subjektit) në shtetin anglez gjatë periudhës 2000 – 2004.

1.6 Subjekti i rivlerësimit ka hapur në datën 16.1.2007 depozitë kursimi⁶ me vlerë 400,000 lekë, e cila është maturuar në datën 16.7.2007 dhe, po në këtë datë, sipas shpjegimeve të tij në pyetësorin nr. 2, kjo depozitë është mbyllur. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se kjo shumë është përdorur prej tij për lejen e ndërtimit të objektit 3 kate + papafingo, pasi

³ Pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, sip. 724 m² dhe pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***. Certifikatat e pronësisë janë lëshuar përkatësisht në datat 27.8.2007 dhe 17.8.2007. Aneksi nr. 4/2 dhe nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴ Pasuria nr. *** është blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.7.2007. Noter R.K; blerës Urim Buci; shitës B, F, M, L dhe S.A. Pasuria nr. *** është blerë me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.7.2007. Noter R. K. Blerës Urim Buci; shitës Xh. dhe B.A.

⁵ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.1.2017, notere V.V, Bashkia K.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021, “Intesa Sanpaolo Bank”.

kishte planifikuar për të ndërtuar banesën në K. dhe se burimi i vlerës 400,000 lekë janë të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez në vitet 2000 – 2004⁷.

1.7 Në përfundim, në analizë të provave të administruara, trupi gjykues i kaloi subjektit barrën e provës sa më poshtë:

- i. Subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë me prova, duke rezultuar në pamundësi financiare në vlerën - 400,000 lekë.
- ii. Subjekti i ka blerë pasuritë tokë arë me çmim më të ulët.

1.8 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me pamundësinë financiare prej 400,000 lekësh dhe shpjegime për vlerën e ulët të blerjes së sipërfaqes së tokës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kërkuan shpjegime, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacionin përkatës⁸. Në lidhje me të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez, shpjegoi ndër të tjera se depozita e kursimit me vlerë 400,000 lekë të depozituar në ‘American Bank of Albania’ në datën 17.1.2007 dhe blerja e pasurisë tokë arë në vlerën 400,000 lekë (për pjesën e tij takuese ½ e shumës 400,000 lekë) janë nga burimi i të ardhurave nga emigracioni në shtetin anglez prej muajit nëntor 2000 deri në muajin qershor 2004. Subjekti thekson se këtë gjë e ka deklaruar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha deklaratimet e tij ndër vite. Gjithashtu ai theksoi se edhe në deklaratën Vetting dhe në pyetësorët lidhur me këtë deklaratë, ai ka deklaruar se të ardhurat e tij nga emigracioni kanë qenë në vlerën rreth 60,000 GBP, të cilat janë mbajtur si kursime prej nënës së tij, sipas traditës familjare shqiptare dhe janë përdorur në periudhat e mëvonshme për ndërtimin e objektit.

1.10 Subjekti ka dhënë sqarime mbi vendet e punësimit të tij në shtetin anglez, duke deklaruar adresat e tyre dhe vendin e punës, si dhe shtetasit me të cilët ka punuar gjatë kohës së qëndrimit në shtetin anglez⁹. Ai sqaroi se ka dërguar vlera monetare disa herë me transfertat me Western Union gjatë qëndrimit të tij në Angli, të cilat janë tërhequr nga babai, nëna ose bashkëshortja e tij. Subjekti depozitoi pranë Komisionit kthim përgjigjen e Western Union, drejtuar subjektit se: “...të dhënat personale të klientëve mbahen deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të

⁷ Bashkëlidhur këtij pyetësori ka përcjellë mandatarëkëtimin, datë 17.1.2007, pranë “American Bank of Albania”, kontratë depozite me datë 17.1.2007, rinovim kontratë depozite me datë 16.4.2007.

⁸ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2023, me deklarues shtetasin A.D; deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2023, me deklarues shtetasin H.D; deklaratë noteriale nr. ***, datë 18.4.2023, me deklarues shtetasin G.D; deklaratë noteriale ***, datë 18.4.2023, me deklarues shtetasin M.B; deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.4.2023, me deklarues shtetasin D.B + librezë personale shëndeti nr. regjistri *** e D.B, në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe + leje qëndrimi, datë 23.6.2000, e D.B, në gjuhën greke, përkthyer në gjuhën shqipe, vërtetuar përkthimi me nr. ***, datë 14.4.2023; shkresë nr. ***prot., datë 12.4.2023, nga Unioni Financiar Tiranë; deklaratë noteriale datë 13.4.2023, me deklarues shtetasin B.M, në gjuhën angleze, përkthyer në gjuhën shqipe + vërtetim përkthimi nr. ***, datë 18.4.2023; deklaratë noteriale datë 13.4.2023, me deklarues shtetasin A.L, në gjuhën angleze, përkthyer në gjuhën shqipe + vërtetim përkthimi nr. ***, datë 18.4.2023, të shtetasit A.L; një zarf (postpack), i cili është dërguar nga subjekti në datën 13.2.2004 nga shteti anglez, nëpërmjet R.M, në adresë të pritësit, bashkëshortes S.B (F); 13 fotografi të realizuara në shtetin anglez të subjektit gjatë viteve 2000 – 2004.

⁹ Shpjegimet i ka shoqëruar me deklaratatë të njohurve të tij me të cilët ka jetuar dhe/ose punuar gjatë kohës së qëndrimit në shtetin anglez (deklarata të sipërpërmendura); me foto të tij me shtetasit të cilët ai ka jetuar dhe punuar, si dhe me foto në ambiente të pretenduara nga ai si vendet e punës së tij. Në funksion të këtyre shpjegimeve, ka përcjellë një zarf postar (PostPack) me emër marrësi S.F dhe dërgues subjekti i rivlerësimit me adresë në shtetin anglez, i cili mban datën 13.2.2004.

marrëdhënies financiare me klientin. Në përfundim të periudhës pesëvjeçare banka fshin këto të dhëna nga skedarët dhe nga sistemi kompjuterik dhe fizik bankar”¹⁰.

1.11 Në lidhje me tërheqjet ka shpjeguar: “...*gjatë kohës së qëndrimit tim në shtetin anglez në vitet 2001-2004, kam dërguar disa herë për familjen time në Shqipëri transferta nëpërmjet institucionit financiar Western Union, me nga 2 mijë GBP secila (me sa më kujtohet, kaq ka qenë limiti i lejuar i çdo transferte), në total rreth 15 mijë GBP, shuma të cilat i ka tërhequr i ndjeri babai im H.V.B. Po ashtu, sikurse e kam deklaruar edhe më parë, gjatë të njëjtës periudhë unë kam dërguar për familjen time në Shqipëri pjesë-pjesë, disa herë, sipas rastit, nga 5-6 mijë GBP, nëpërmjet shokëve të mi që ishin me dokumente të rregullta”.*

1.12 Në vijim ka shpjeguar: “*Këto para ata ia kanë dorëzuar sipas porosisë sime nënës, M.SH.B, e cila ka luajtur rolin e kryefamiljares. Sqaroj se këto shuma monetare i janë dorëzuar nënës M.SH.B, pasi në atë kohë vëllai im D.B kishte probleme shëndetësore dhe i ndjeri babai im H.B ishte i sëmurë. Në vitin 2008, kur unë subjekti kisha marrë lejen e ndërtimit për të ndërtuar shtëpinë ‘godinë e kombinuar 3 kate’, nëna ime M.SH.B i kishte ruajtur një pjesë të këtyre parave pa më treguar më parë për këtë dhe m’i ka dhënë për të ndërtuar shtëpinë¹¹”.*

1.13 Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave dhe me mundësinë për të siguruar dokumentacionin provues, ka shpjeguar: “...*të gjitha të ardhurat e siguruara prej meje nga emigracioni në Angli nuk janë të paligjshme, por janë të ardhura nga puna ime e ndershme, e kryer si çdo emigrant tjetër. Kalimi i këtij afati që para periudhës që unë u bëra subjekt deklarues në vitin 2015, e bën të pamundur të siguroj dokumentacion provues, pavarësisht të gjitha përpjekjeve ligjore që kam bërë, kjo edhe për faktin se ka kaluar afati i ruajtjes nga viti 2000 – 2004 deri aktualisht... Unë subjekti Urim H. Buci jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë (blerjes së pasurisë tokë arë në vlerën 400,000 lekë, për pjesën time takuese ½ të shumës 400,000 lekë) me të ardhura nga emigracioni në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004, prandaj, ju lutem, pasi të krijoni bindjen e brendshme t’i referoheni nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.*

1.14 Sa i përket blerjes së tokës me çmim më të ulët sesa çmimi real në vitin 2007, subjekti sqaroi se për këtë sipërfaqe toke prej 1000 m² familja e tij dhe, konkretisht babai i tij, i ndjeri H.V.B, ka bërë një marrëveshje verbale me shtetasin B.K.A dhe familjarët e tij që në vitin 1998, duke rënë dakord për çmimin e blerjes së tokës arë prej 1000 m² (ndarë në dy parcela, 724 m² dhe 276 m²) në vlerën 400,000 lekë, pavarësisht se kontrata e shitjes dhe çmimi i blerjes janë konkretizuar në vitin 2007. Ai ka sqaruar se marrëveshja verbale për shitblerjen e kësaj toke është bërë në një kohë që zona e Kamzës ishte e paurbanizuar dhe mbushur me ndërtime informale, sikurse pothuajse 90% e banorëve të zonës e kishin blerë tokën për ndërtimin e objekteve informale me çmime qesharake nga të ashtuquajturit “pronarë zaptues” dhe se, për më tepër, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, nuk ka pasur çmime reference, por llogariteshin në bazë të çmimit të kontratës.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2023 nga Unioni Financiar Tiranë.

¹¹ Bashkëlidhur ka përcjellë deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.4.2023, të nënës së tij, znj. M.B, e cila konfirmon deklaratimet prej tij në parashtrime.

1.15 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

1.16 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Subjekti e ka deklaruar saktë këtë pasuri si në deklaratat periodike dhe në atë *Vetting*.
- Kjo pasuri është një pasuri e krijuar shumë vite para detyrës së tij si prokuror dhe subjekti i ligjit nr. 84/2016.
- Duke qenë se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni i subjektit në Angli, të cilat janë edhe burim krijimi të pasurisë nr. ***, analiza e tyre është trajtuar në pasurinë nr. ***.
- Çmimi i blerjes së kësaj pasurie vlerësohet si shprehje e lirisë kontraktuale të palëve në një marrëdhënie juridike civile.

2. *“Godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, ndërsa një pjesë është në proces legalizimi. Konkretisht, pjesa me leje ndërtimi është miratuar me vendim të KRRT-së, datë 3.7.2008, të Bashkisë K., për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m² (3 kate), sipërfaqe gjurmë ndërtimi 89 m² (kati i parë). Aktualisht janë përfunduar 3 kate. Objekti nuk është regjistruar akoma në ZVRPP-në Tiranë. Pjesa e objektit në proces legalizimi ka sipërfaqe 50 m², secili kat (3 kate) dhe në total të tria katet 150 m². Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi) është në posedim të dhëndrit tim G.D, pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G.D, i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh”.*

Burimi i krijimit: të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.

Vlera: 6,918,105 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

2.1 Në DIPP-në para fillimit të detyrës si Oficer i Policisë Gjyqësore, datë 1.8.2005, subjekti ka deklaruar se ka në bashkëpronësi me vëllain një banesë dykatëshe, të ndërtuar vetë në vitin 1995 dhe të pahipotekuar. Ka deklaruar se në këtë banesë ai zotëron 50% dhe se vlera e saj në momentin e krijimit ka qenë 10,000,000 lekë. Në lidhje me këtë vlerë, si para ILDKPKI-së (procesverbal i mbajtur nga kjo e fundit gjatë pyetjes së subjektit), ashtu edhe pranë Komisionit, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka sqaruar se deklarimi i shumës 10,000,000 lekë ka qenë një lapsus i tij, pasi u është referuar 10 milionë lekëve të vjetër. Ky objekt 2-katësh ndodhet në K., rruga “****” dhe sipas shpjegimeve të subjektit¹², është ndërtuar së bashku me vëllain, më tepër me kontribute të vëllait nga emigracioni në vitet 1995 – 2001. Ka filluar të ndërtohet nga vëllai i tij D.B që nga viti 1995 dhe ka përfunduar në vitin 2006. Ky objekt është vetëdeklaruar për legalizim në vitin 2015, një pjesë e godinës në emër të subjektit dhe pjesa

¹² Në procesverbalin e mbajtur para ILDKPKI-së në vitin 2016 dhe para Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit.

tjetër në emër të vëllait të tij D.B, duke u bazuar në ndarjen e tokës 1000 m², në dy pjesë të barabarta.

2.2 Objekti 3 kate + papafingo është deklaruar nga subjekti në DIPP-në para fillimit të detyrës si prokuror, nëntor 2015, me të njëjtat sipërfaqe, si në deklaratën *Vetting*. Gjatë procesit, subjekti ka sqaruar se objekti 3-katësh, i deklaruar në deklaratën *Vetting*, është ndërtuar si vazhdimësi e objektit 2-katësh të deklaruar në vitin 2005 (në të cilin subjekti kishte 50%, konkretisht 62,55 m², ndërsa gjysma tjetër ishte e vëllait të tij D.B) dhe se, edhe mbi objektin ekzistues 2-katësh është ndërtuar kati i tretë (si vazhdimësi e katit të tretë të objektit 3-katësh), nga bashkëshorti i motrës së tij, z. G.D (sqaruar në vijim).

2.3 Me deklaratën noteriale datë 25.1.2017¹³, me deklarues Urim H. Buci dhe G.G.D, subjekti Urim Buci ka deklaruar se mbi pasuritë nr. *** dhe ***, në pronësi të tij, është ndërtuar një objekt 3-katësh. Një pjesë e objektit është ndërtuar me leje ndërtimi (të sipërpërmendur) dhe nga leja nuk është ndërtuar papafingoja. Mbi këtë sipërfaqe prone, ngjitur me këtë objekt, është ndërtuar pa leje ndërtimi, por e vetëdeklaruar për legalizim një objekt me 3 kate, me sip. 50 m²/kat. Subjekti Urim Buci ka deklaruar se kati i tretë i dy objekteve është në posedim të dhëndrit të tij (duke iu referuar kumatit të tij), z. G.D, pasi ai është investitori i ndërtimit të katit të tretë të dy objekteve dhe të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të dy objekteve, përveç karabinasë, janë bërë nga dhëndri i tij G.D. Ky i fundit ka deklaruar se është dakord me sa është deklaruar më sipër, pasi ai (z. G.D) ka ndërtuar dhe mobiluar katin e tretë të dy objekteve dhe aktualisht banon në këtë objekt.

2.4 Me vendimin nr. 7, datë 3.7.2008, të KRRT-së së Bashkisë K., është miratuar leje ndërtimi për objekt “godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo”, me investitor z. Urim Buci, kontratë me shoqërinë e ndërtimit “S” sh.p.k., Lagjja Nr. ***, K.. Sipas kësaj leje, sheshi i ndërtimit të këtij objekti ndodhet në z. k. ***, nr. pasurie ***. Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit është 724 m², sipërfaqja e gjurmës së ndërtimit është 89 m² dhe sipërfaqja totale e ndërtimit është 318 m².

2.5 Sipas situacionit të punimeve, nënshkruar në datën 15.9.2016 nga shoqëria “S” sh.p.k. dhe drejtuesi teknik, vlera totale e punimeve është 6,918,105 lekë¹⁴. Në këtë situacion është vendosur shënimi: “1. Ky situacion përfshin dy kate të përfunduara dhe një kat (kati i dytë teknik) në fazën e karabinasë (sipas lejes së ndërtimit), si dhe katin e dytë teknik në objektin ekzistues dy kate. 2. Një pjesë e punimeve është kryer nga vetë familjarët”.

2.5.1 Komisioni hetoi mbi ekzistencën e konfliktit të interesit të subjektit për shkak të detyrës së tij me subjektin ndërtues “S” sh.p.k. dhe nuk rezultoi që ai të ketë hetuar çështje, ku ky subjekt të ketë qenë pjesëmarrës me çfarëdolloj cilësie¹⁵.

2.6 Në datën 26.12.2014 (protokolluar pranë ALUIZNI-t në datën 7.1.2015) subjekti ka aplikuar për përfshirje në procedurat e legalizimit për ndërtim pa leje; sipas vetëdeklarimit, ndërtimi është ngritur në vitin 2006 dhe ndodhet në adresën: rruga “****”, Nr. ***, K.¹⁶.

¹³ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.1.2017, notere V.V.

¹⁴ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁵ Shkresat e administruara në Komision me nr. *** prot., datë 5.12.2022, nr. *** prot., datë 16.12.2022 dhe nr. ***, datë 23.12.2022, dërguar përkatësisht nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Kurbin, Vlorë dhe Fier.

¹⁶ Aneks nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

2.7 Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ASHK-ja¹⁷ rezulton se:

2.7.1 Me leje legalizimi datë 12.7.2018 është miratuar legalizimi për objektin “godinë e kombinuar 3 kate”, në favor të shtetasve Urim H. Buci dhe G.G.D. Sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 87.05 m²; sipërfaqe ndërtimi 59.2 m²; sipërfaqja totale e ndërtimit për banim është 125.1 m²; dhe për aktivitet 62.55 m². Pjesë e dosjes së legalizimit është deklarata noteriale nr. ***, datë 2.6.2018, e shtetasve Urim Buci, S.B dhe G.D. Në këtë deklaratë, ata kanë deklaruar se në pasurinë e vetëdeklaruar për legalizim si më lart, Urim dhe S. B janë bashkëpronarë në 2/3 e objektit (në katin e parë që është për biznes dhe në katin e dytë, për banim), ndërsa z. G.D është pronar i 1/3 së objektit (vetëm i katit të tretë, për banim).

2.7.2 Objekti është regjistruar në datën 14.2.2019, me nr. pasurie ***¹⁸, në bashkëpronësi të shtetasve Urim Buci dhe G.D, me sip. 59.20 m²¹⁹. Ai është regjistruar fillimisht pa marrëdhënie me truallin dhe ndodhej mbi pasuritë me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. K*** dhe nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***²⁰. Pasuritë nr. *** dhe ***, mbi të cilat shtrihej objekti, janë regjistruar respektivisht në pronësi të shtetasve Urim H. Buci dhe D.H.B, me sip. 500 m²/secila. Pasuria nr. ***, në datën 2.8.2018, i është dhuruar²¹ shtetasit D.B nga vëllai i tij, subjekti i rivlerësimit Urim Buci.

2.8 Në lidhje me mospërputhjen e numrave të pasurive, mbi të cilat shtrihej objekti sipas deklaramentit në deklaratën *Vetting* (nr. *** dhe nr. ***, z. k. ***) dhe sipas kartelës së pasurisë (nr. *** dhe nr. ***, z. k. ***), subjekti sqaroi historikun e këtyre pasurive, si vijon: “*Pasuritë e llojit arë me nr. ***, sipërfaqe 724 m² dhe nr. ***, me sipërfaqe 276 m², janë bashkuar në një të vetme duke sjellë një sipërfaqe totale prej 1000 m², duke mbartur nr. ***, e cila është regjistruar në vol. ***, f. ***, z. k. ***, K., Tiranë, në emër të Urim H. Buci, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 21.6.2017.*

*Më pas është vijuar me ndarjen e sipërfaqes prej 1000 m² në dy sipërfaqe me nga 500 m²/secila, përkatësisht me nr. *** dhe nr. ***. Pasuria nr. ***, regjistruar në vol. ***, f. ***, z. k. ***, K., Tiranë, në emër të Urim H Buci, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 21.6.2017.*

*Në vijim, pasuria me nr. *** i është dhuruar vëllait tim D.B, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 30.8.2018 (mbi të cilën shtrihen objektet godinë 2 kate dhe lokali 1-katësh bar-kafe). ...pra, këto objekte të vëllait tim D.B ndodhen mbi pasurinë me nr. *** (ardhur si rrjedhojë e bashkimit dhe ndarjes së pasurive të sipërcituara).*

*Objekti godinë e kombinuar 3 kate në bashkëpronësi me dhëndrin tim G.G.D ndodhet mbi pasurinë me nr. *** (ardhur si rrjedhojë e bashkimit dhe ndarjes së pasurive të sipërcituara)..., e cila është në pronësinë time”.*

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 23.3.2021), e ASHK-së, DV K, Vorë.

¹⁸ Z. k. ***, vol. ***, f. ***, indeks harte ***. Sipërfaqja e katit përdhe = 59.2 m²; sipërfaqja e katit të parë = 62.55 m²; Sipërfaqja e katit të dytë = 62.55 m² (shihni përshkrim i veçantë në kartelën e pasurisë).

¹⁹ Në zërin përshkrim i veçantë sqarohet: sipërfaqja e katit përdhe = 59.2 m², sipërfaqe kati i parë = 62.55 m², sipërfaqe kati i dytë = 62.55 m².

²⁰ Përshkrimi në seksionin D të kartelës së pasurisë.

²¹ Kontratë dhurimi nr. ***, datë 2.8.2018, noter L. V, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 11.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 11.3.2021). Vendorsur si shënim edhe në kartelën e pasurisë.

Historiku i ndryshimit të numrave të pasurive si më lart është konfirmuar edhe nga ASHK-ja.

2.9 Shtetasit Urim Buci dhe G.D në vitin 2018 kanë deklaruar²² se janë pajisur me leje legalizimi për objektin “godinë e kombinuar 3 kate”, që ndodhet në z. k. ***, nr. pasurie *** dhe se në këtë objekt z. Urim Buci është disponues i katit përdhe dhe katit të parë, ndërsa z. G.D është disponues i katit të tretë. Po në këtë vit, të dy bashkërisht kanë autorizuar me prokurë një përfaqësues që t’i përfaqësojë ata pranë ZVRPP-së Tiranë²³.

2.10 Subjekti, personi i lidhur i tij, znj. S.B (bashkëshortja e subjektit), dhe z. G.D, në datën 2.6.2018 kanë deklaruar²⁴ se në objektin e vetëdeklaruar Urim dhe S.B janë bashkëpronarë në 2/3-at e tij, konkretisht në katin e parë për biznes dhe katin e dytë banim, ndërsa z. G.D ka në pronësi vetëm katin e tretë, me funksion banimi. Por, po në të njëjtën deklaratë, në një pjesë të saj, Urim dhe S.B deklarojnë: *“Të dyja katet janë tonat, ndërsa kati i tretë për banim është në bashkëpronësi me z. G.D”*. Ndërsa, në procesverbalin e mbajtur para ILDKPKI-së, në datën 6.9.2016, subjekti kishte deklaruar se: *“Në katin e tretë banon dhëndri im, pa detyrim për momentin”*. Tarifa e shërbimit për legalizim për të tria katet, në vlerën 8,000 lekë, është kryer nga subjekti i rivlerësimit Urim Buci.

2.11 Komisioni, me qëllim analizimin e plotë të elementeve që të çojnë në një deklaram të mjaftueshëm të kësaj pasurie, hetoi lidhur me kohën e kryerjes së ndërtimit, fillimin e ndërtimit, punimet e kryera, vlerën e investimit, elemente këto shumë të rëndësishme në procesin e rivlerësimit.

2.11.1 Subjekti sqaroi²⁵ se:

- Në deklaramin e vitit 2005 kishte përfunduar kati i parë (përdhe) i objektit 2-katësh të ndërtuar nga vëllai i tij në vitet 1995-2006 dhe kati i dytë (kati i parë banim) ka qenë karabina (vetëm kolona dhe soletë) deri në vitin 2015. Ka sqaruar se ai zotëron 50% të këtij objekti 2-katësh, i cili është përfshirë në certifikatën e pronësisë në datën 9.11.2021 dhe aktualisht është pjesë e objektit “godinë e kombinuar 3 kate”, ku kati i tretë është në pronësi të z. G.D. Ka deklaruar gjithashtu se punimet e ndërtimit për objektin 2-katësh janë kryer nga vetë vëllai D.B dhe jo nga shoqëria e ndërtimit “S” sh.p.k., pasi vëllai këtë profesion e ushtronte prej kohësh në shtetin grek dhe vlera në momentin e krijimit ka qenë 10 milionë lekë të vjetër. Gjithashtu, po në këtë pyetësor, subjekti ka sqaruar se ngjitur me objektin 2-katësh, vëllai i tij D.B në vitin 2009 ka ndërtuar edhe një shtesë të re, po 2 kate, të cilën e ka në proces legalizimi dhe, gjatë viteve 1995 – 2006, ka ndërtuar edhe një lokal 1-katësh, i cili ndodhet para objektit të tij 2-katësh.
- Po në përgjigjet e këtij pyetësori, subjekti ka sqaruar se objekti 3-katësh ka filluar të ndërtohet në vitin 2008 dhe ka përfunduar në vitin 2010 si karabina (kolona, soletë dhe mur me tulla) sipas lejes së ndërtimit: *“Nga muaji shtator dhe aktualisht kati përdhe është i përfunduar. Shtesa e re e katit të parë banim është karabina (aktualisht është i papërfunduar) dhe pjesa e vjetër e objektit 2-katësh është përfunduar dhe shfrytëzuar si shtëpi banimi. Kati i dytë banim (shtesa e re) nga ana ime është bërë vetëm karabina dhe*

²² Deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.12.2018, notere V.V, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, DV K, Vorë, me shkresën e referuar më lart.

²³ Prokurë nr. ***, datë 3.9.2018, pjesë e dosjes së ASHK-së.

²⁴ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 2.6.2018, noter L.V, pjesë e dosjes së ASHK-së.

²⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

*është përfunduar e shfrytëzohet aktualisht për banim nga shtetasi G.G.D (dhëndri im), i cili i ka kryer punimet vetë dhe në datën 9.11.2021 është pajisur me certifikatë pronësie për katin e dytë banim... Për shkak të mbarimit të afatit të lejes së ndërtimit, nuk është ndërtuar papafingo dhe kjo ka qenë arsyeja që si pjesa e objektit me leje ndërtimi, edhe pjesa në proces legalizimi (gjysma e objektit 2-katësh ndërtuar nga vëllai im D.B), vetëdeklaruar me deklaratën nr. *** prot., datë 7.1.2015, i është nënshtruar ligjit për legalizimet. Për këtë arsye, kemi bërë kërkesën për legalizim nr. ***, datë 5.6.2021, unë dhe dhëndri im G.D”.*

2.11.2 I pyetur nga Komisioni²⁶ mbi arsyen pse ky objekt 2-katësh, i ndërtuar së bashku me vëllain, më tepër me kontributet e tij nga emigracioni, nuk është regjistruar në bashkëpronësinë e tij dhe të vëllait, subjekti shpjegoi se arsyeja është fakti që nga i ndjeri babai i tyre, kjo pasuri e cila rridhte nga familja e madhe, është ndarë midis dy vëllezërve në pjesë të barabarta, pavarësisht nga kontributi i secilit vëlla.

2.11.3 Me pyetësorin nr. 2, subjekti përcolli në Komision edhe një akt konstatimi punimesh, hartuar në datën 23.11.2022 për objektin “shtesë anësore dhe shtesë në lartësi në objektin ekzistues 1 kat (objekti përfundimtar godinë shërbimi dhe banimi 3 kate)”, me investitor shtetasit Urim H. Buci dhe G.G.D, me vendndodhje në Bashkinë K.. Sipas këtij aktkonstatimi, punimet e kryera, koha e kryerjes së tyre dhe vlera e investimeve janë si vijon:

- 2008 – 2010 (karabina-shtesë anësore në objekt ekzistues), nga investitori Urim Buci, me vlerë 1,238,680 lekë;
- 2010 – 2015 (rifiniturat-shtesa anësore në objektin ekzistues), nga investitori Urim Buci, me vlerë 2,337,900 lekë;
- 2008 – 2010 (karabina-shtesa kati 2), investitor G.D, me vlerë 1,139,600 lekë;
- 2010 – 2015 (rifiniturat-shtesa kati 2), investitor G.D, me vlerë 1,052,360 lekë.

2.11.4 Referuar këtij aktkonstatimi, shuma totale e investuar nga z. Urim Buci është 3,576,580 lekë, ndërsa shuma e investuar nga z. G.D është 2,191,960 lekë.

2.11.5 Gjithashtu, sipas deklarimeve të bëra nga subjekti në përgjigje të këtij pyetësori, nga vlera e deklaruar prej 6,918,105 lekësh në situacionin e datës 15.9.2016 duhet të hiqet vlera e katit të dytë banim, pasi punimet janë kryer dhe është përfunduar e shfrytëzuar për banim nga vetë shtetasi G.D, ndërsa subjekti e ka ndërtuar vetëm si karabina. Ka shpjeguar gjithashtu se nga vlera e sipërpërmendur e deklaruar në situacionin e vitit 2016 duhet të zbritet edhe vlera e katit të parë banim (shtesa e re), e cila aktualisht është e papërfunduar.

2.11.6 I pyetur nga Komisioni²⁷ nëse në vlerën 6,918,102 lekë përfshihet edhe godina ekzistuese 2-katëshe, subjekti deklaroi: *“Në këtë vlerë përfshihen punimet e ndërtimit të katit të dytë të objektit ekzistues 2 kate, përveç kolonave dhe soletës (karabinasë), që ishte ndërtuar më parë nga vëllai im D.B”.*

2.11.7 Në lidhje me pyetjen e Komisionit²⁸ nëse ka përfituar kundërvleftë monetare nga z. G.D për karabinanë e katit të tretë të ndërtuar prej tij, të cilën ia ka kaluar në pronësi këtij shtetasi, subjekti deklaroi: *“Nuk kam përfituar kundërvlerë monetare nga z. G.D. Kemi rënë dakord që,*

²⁶ Pyetësori nr. 2.

²⁷ Pyetësori nr. 5

²⁸ Pyetësori nr. 5.

meqenëse unë subjekti kam kryer shpenzimet e ndërtimit të karabinasë sipas lejes së ndërtimit, dhëndri im, z. G.D, do të kryente në të ardhmen disa punime shtesë në funksion të të dyja palëve. Konkretisht, ky shtetas ka kryer rifiniturën e objektit me sistem kapot (bukë peshku dhe suvatime të jashtme të objektit) dhe izolimin e soletës. Këto shpenzime janë kryer nga z. G.D në vitin 2020”.

2.11.8 Subjekti sqaroi²⁹ se në objektin 3 kate nuk është kryer asnjë investim pas vitit 2016, përveç dritareve duralumini të përdorura, të vendosura prej tij pas vitit 2016 në pjesën e katit të dytë (katit të parë banim), ende i papërfunduar edhe aktualisht, dhe rifiniturë objekti me sistem kapot, si dhe izolim solete, të kryera nga shtetasi G.D në vitin 2020. Vlera e dritareve duralumini të përdorura, sipas shpjegimit të tij, është përfshirë në situacionin e punimeve totale të objektit 3 kate, që mban datën 23.11.2022.

2.11.9 Me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, subjekti sqaroi se sipërfaqja totale e katit të parë banim (kati i dytë teknik) i objektit 3 kate, me nr. pasurie ***, z. k. ***, është 180.65 m²: *“Në këtë kat kanë përfunduar punimet për një sipërfaqe rreth 100 m² gjatë vitit 2015 nga unë subjekti, përveç karabinasë që ka qenë pjesë e objektit 2 kate ekzistues, ndërtuar nga vëllai im z. D.B para vitit 2006 (sqaruar në pyetësorët e mëparshëm). Vlera e investimit është saktësuar në situacionin e datës 23.11.2022”.*

2.11.10 Bashkëlidhur përgjigjeve të këtij pyetësori, subjekti ka përcjellë në Komision foto të pjesëve të brendshme të katit të parë banim për pjesën ende të papërfunduar. Nga fotot evidentohet që objekti nga brenda është i papërfunduar.

2.11.11 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të paraqitur foto të zhvillimit ndër vite të objektit 3-katësh (pjesa me leje dhe ajo pa leje), subjekti u përgjigj se nuk janë kryer foto të zhvillimit ndër vite të këtij objekti, përveç atyre që i ka paraqitur më parë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5 ka paraqitur foto aktuale të objektit, duke evidentuar qartësisht pjesën ekzistuese të objektit, pjesën me leje ndërtimi dhe pjesën pa leje, si dhe pronësinë e secilës prej tyre. Gjithashtu, ka sqaruar edhe pjesën e objektit në zotërim të vëllait të tij D.B, si dhe ka paraqitur ortofoto të viteve 2007 dhe 2015, nga të cilat evidentohet ndryshimi i objektit nga viti 2007 (pa pjesën e shtuar) në vitin 2015 (me shtesën e bërë).

2.12 Nga dokumentacioni i pronësisë dërguar nga ai bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 5.8.2021, të ASHK/DV K., Vorë, është miratuar legalizimi i ndërtimit pa leje 3 kate (shtesë anësore), poseduar nga shtetasi Urim H. Buci dhe G.G.D. Sipërfaqja ndërtimore është 250.7 m² banim, sipërfaqe 111.1 m² social-ekonomik; sipërfaqja e bazës së ndërtimit është 111.1 m²; sipërfaqja e parcelës ndërtimore është 188.5 m².

2.13 Pasi është bërë bashkimi i dy pasurive të legalizuara me dy lejet e legalizimit si më lart (të viteve 2018 dhe 2021), është bërë pjesëtimi vullnetar i tyre, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka marrë në pronësi katin përdhe dhe katin e parë banim, ndërsa z. G.D ka marrë në pronësi katin e dytë banim³⁰.

²⁹ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 7.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 28.2.2023) dhe kontratë pjesëtimi vullnetar nr. ***, datë 3.11.2021, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja me këtë shkresë.

2.13.1 Në bazë të pjesëtimit të bërë si më lart, në nëntor të vitit 2021, subjekti Urim Buci dhe z. G.D janë pajisur me certifikatat e pronësisë sipas pjesëve takuese për objektin “godinë e kombinuar 3 kate”, në K., Tiranë. Konkretisht:

- pasuria e llojit “njësi”, me nr. ***, sip. 132.48 m², z. k. 2066, pronar Urim Buci;
- pasuria e llojit “apartament”, me nr. ***, sipërfaqe totale 180.65 m², pronar Urim Buci;
- pasuria e llojit “apartament”, me nr. ***, sipërfaqe totale 175.1 m², pronar G.D.

2.14 Në lidhje me vlerën e investimit të kryer nga subjekti në ndërtesën e kombinuar 3 kate, Komisioni konstatoi pasaktësi në deklarinimin e tij, pasi në deklaratën *Vetting* deklaroi vlerën 6,918,105 lekë³¹, ndërsa me pyetësin nr. 2 përcjell aktkonstatim punimesh të realizuar në datën 23.11.2022, me vlerën e punimeve të kryera nga subjekti prej 3,576,580 lekësh. Komisioni, në kushtet e mungesës së provave mbi periudhën e kryerjes së punimeve, është mbështetur në sa vijon për kryerjen e analizës:

- Për ndërtesën 2 kate janë konsideruar deklarinimet në deklaratën e interesave privatë periodikë të plotësuar nga subjekti si OPGJ në vitin 2005³² dhe vetëdeklarimi³³ i tij pranë ALUIZNI-t (kërkesë e plotësuar prej tij në datën 26.12.2014 dhe protokolluar prej ALUIZNI-t në datën 7.1.2015). Po ashtu, në shpjegimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit³⁴ ka deklaruar se vëllai i tij D.B ka kryer punimet e ndërtesës 2 kate, duke ndërtuar plotësisht katin përdhe (kati i parë teknik) dhe karabinanë e katit të parë banim (kati i dytë teknik). Në fotografimin ajror (ortofto) të vitit 2009, karabinaja e katit të tretë (kati i dytë banim) rezulton e përfunduar. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se i ka kryer ai punimet e saj (karabinasë), kurse në aktin e konstatimit të përcjellë me pyetësin nr. 2 të gjitha punimet për këtë kat (përfshirë dhe karabinanë) janë paraqitur si të kryera nga z. G.D. Në lidhje me këtë mospërputhje, në analizë Komisioni mori në konsideratë deklarinimin e subjektit në deklaratën *Vetting*. Në analizë u konsiderua se ndërtimi i katit përdhe dhe karabinaja e katit të parë banim është realizuar nga shtetasi D.B. Ndërtimi i karabinasë në katin e dytë banim (kati i tretë teknik) ka qenë i përfunduar në vitin 2009³⁵ nga subjekti dhe punimet e tjera (përveç karabinasë) për përfundimin (plotësimin) e katit të parë të banimit (kati i dytë teknik) janë kryer deri në vitin 2015 nga subjekti i rivlerësimit.

Vlera e investuar në këtë godinë nga subjekti i rivlerësimit është paraqitur në tabelën si vijon:

³¹ Sipas shpjegimeve të subjektit, kjo vlerë vjen nga situacioni i punimeve datë 15. 9.2016 i shoqërisë “S” sh.p.k., ku është vendosur shënimi: “*1. Ky situacion përfshin dy kate të përfunduara dhe një kat (kati i dytë teknik) në fazën e karabinasë (sipas lejes së ndërtimit), si dhe katin e dytë teknik në objektin ekzistues dy kate*”.

³² Deklaron se ka në bashkëpronësi me vëllain një banesë dykatëshe, të cilën e kanë ndërtuar vetë në vitin 1995 dhe është e pahipotekuar. Ka deklaruar se në këtë banesë ai zotëron 50% dhe se vlera e saj në momentin e krijimit është 10,000,000 lekë (të vjetër).

³³ Deklaron se viti i ndërtimit të objektit është 2006.

³⁴ Pyetësor nr. 2 (përgjigje e pyetjes nr. 1) dhe shtojca e aktkonstatimit, datë 23.11.2022, përcjellë me pyetësin nr. 5.

³⁵ Sqarim: për efekt të llogaritjeve, vlera sipas EKB-së për vitet 2008 dhe 2009 është e njëjtë.

	<i>sip. m²</i>	<i>Viti i ndërtimit</i>	<i>EKB – kosto ndërtimi</i>	<i>Investimi me kosto EKB</i>	<i>TVSH + fondi i fitimit (25%)</i>	<i>Kosto për çdo kat, zbritur TVSH dhe fondi i fitimit</i>
Kati përdhe	59.2 m ²	Para vitit 2006	Realizuar nga z. D.B			
Kati i parë	62.55 m ²	Ndërtimi i karabinasë para 2006 dhe plotësimi i ndërtimit gjatë 2015	55,6% ³⁶ e EKB-së së vitit 2015 - 32,113 lekë/m ²	1,116,819	279,205	837,615
Kati i dytë	62.55 m ²	Ndërtimi i karabinasë 2009 dhe përfundimi i ndërtimit nga z. G.D në vitet 2010 – 2015	44,4% e EKB-së së vitit 2009 - 33,174 lekë/m ²	921,315	230,329	690,986
Totali i investimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në godinën ekzistuese						1,528,601

Rezulton se vlera e investimit të realizuar nga subjekti i rivlerësimit në ndërtesën ekzistuese gjatë viteve 2008 – 2015 është 1,528,601 lekë.

- Ndërtesa me leje ndërtimi e vitit 2008 (shtesë anësore 3 kate): subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* leje ndërtimi të miratuar me vendimin nr. 7, datë 3.7.2008, të KRRT-së së Bashkisë K., ku afati i lejes ishte nëntori i vitit 2008. Komisioni vëren se nga ortofotot e vitit 2009 karabinaja e ndërtesës 3 kate (shtesa me leje ndërtimi) rezulton e përfunduar, por ka përfunduar edhe karabinaja e katit të tretë të godinës ekzistuese. Ndërsa në fotot e përcjella prej subjektit në ILDKPKI me përgjigjet e procesverbalit datë 6.9.2016 dhe nga fotot e marra nga *Google Maps*³⁷, të realizuara në maj 2016, duket se kanë përfunduar punimet e ndërtimit në katin përdhe të shtesës anësore të godinës, kati i parë i banimit është pjesërisht karabina dhe kati i dytë i banimit (kati i tretë teknik) në të dyja pjesët e godinës (ekzistuese dhe shtesa anësore) është i ndërtuar plotësisht. Me pyetësorin nr. 2 subjekti ka sqaruar se objekti 3-katësh ka nisur ndërtimin në vitin 2008 dhe ka përfunduar në vitin 2010 si karabina. Shpjegon se nga shtatori i vitit 2015 dhe aktualisht kati përdhe është i përfunduar, kati i parë i banimit është karabina, ndërsa në katin e dytë ka kryer vetëm punimet karabina, të cilat janë vijuar më tej nga z. G.D. Sipas aktkonstatimit të punimeve, bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, vlera totale e punimeve të karabinasë në shtesën anësore të kryera gjatë periudhës 2008 – 2010 është 1,238,680 lekë. Me pyetësorin nr. 7 subjekti ka shpjeguar se nuk është përfunduar plotësisht kati i parë i banimit (kati i dytë i teknik) për një sipërfaqe prej 80 m², ndërsa kanë përfunduar punimet për sipërfaqen 100 m² (ku përfshihet edhe sip. 62.55 m² e godinës ekzistuese, e cila është analizuar më lart), punime të cilat janë kryer kryesisht në vitin 2015.

Vlera e investuar në këtë godinë (shtesa 3 kate) nga subjekti i rivlerësimit është konsideruar si vijon në analizën e Komisionit:

³⁶ Llogaritjet sipas praktikës së Komisionit dhe Kolegjit, mbështetur në marrëveshjen e datës 17.5.2006 midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve “Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”.

³⁷ <https://www.google>

	<i>Sip. m²</i>	<i>Viti i ndërtimit</i>	<i>EKB – kosto ndërtimi</i>	<i>Investimi me kosto EKB</i>	<i>TVSH + fondi i fitimit (25%)</i>	<i>Kosto për çdo kat, zbritur TVSH & fondi i fitimit</i>
Kati përdhe	111.1	2008 – 2010	Karabina 44.4% e EKB të mesatare të viteve 2008-2010	1,636,420	409,105	1,227,315
		2015	55,6% e EKB-së së vitit 2015 - 32,113 lekë/m ²	1,983,671	495,918	1,487,754
Kati i parë (nga sip. 100 m ² e përfunduar zbritet pjesa e trajtuar më lart e godinës ekzistuese prej 62.55 m ² dhe rezulton se ka ndërtuar sip. 37.45 m ² të katit të parë në vitin 2015)	128.1	2008 – 2010	Karabina 44.4% e EKB të mesatare të viteve 2008-2010	1,886,818	471,704	1,415,113
	37.45	2015	55,6% e EKB-së së vitit 2015 - 32,113 lekë/m ²	668,663	167,166	501,497
Kati i dytë	122.6	2008 – 2010	Karabina 44.4% e EKB-së të mesatare të viteve 2008-2010	1,805,807	451,452	1,354,355
Totali i investimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në godinën me leje ndërtimi						5,986,035

Rezulton se vlera e investimit të realizuar nga subjekti i rivlerësimit në ndërtesën me leje ndërtimi gjatë viteve 2008 – 2015 është 5,986,035 lekë.

Duket se vlera totale e investimit të kryer nga subjekti i rivlerësimit është 7,514,635 lekë.

2.15 Me qëllim hetimin e plotë në lidhje me pronësinë dhe posedimin e katit të tretë të objektit, tagrat e z. G.D në këtë kat dhe kohën kur ai ka filluar ta posedojë atë, Komisioni, krahas të dhënave si më lart, mori në konsideratë edhe informacionin e administruar nga Ujësjiellës-Kanalizime K. sh.a. dhe nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU/OSHEE), si dhe shpjegimet e subjektit. Në lidhje me këtë, parashtrahet si vijon:

2.15.1 Nga informacioni i administruar nga Ujësjiellës-Kanalizime K. sh.a.³⁸ rezulton se:

- Subjekti U.B ka lidhur me këtë ndërmarrje kontratë furnizimi me ujë të pijshëm në datën 8.7.2010 (kontrata nr. ***) për objektin e ndodhur në rrugën “****” dhe sqaroi³⁹ se kjo kontratë furnizon të dyja katet e objektit (kati përdhe/shërbime dhe kati i parë banim).

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 7.10.2022) dhe nr. *** prot., datë 28.2.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.3.2023).

³⁹ Pyetësor nr. 6.

- Shtetasi G.G.D ka lidhur me Ndërmarrjen Ujësjellës-Kanalizime K. sh.a. kontratë furnizimi me ujë të pijshëm në datën 6.1.2016 (kontrata nr. ***) për objektin e ndodhur në rrugën “****”, K. dhe pagesat kanë nisur nga muaji shkurt i vitit 2016.

2.15.2 Nga informacioni i marrë nga FSHU-ja⁴⁰ dhe nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 6, rezultoi se me abonentin Urim H. Buci janë lidhur tri kontrata për furnizimin me energji elektrike dhe më pas, njëra prej tyre ka kaluar në emër të z. G.D, në emër të të cilit rezulton edhe aktualisht. Konkretisht:

- Kontrata nr. ***, me kod klienti ***, është hapur në datën 20.4.2015. Kjo kontratë i përket katit të parë banim.
- Kontrata nr. ***, me kod klienti *** është hapur në datën 27.3.2009. Kjo kontratë i përket katit përdhe-shërbime.

Me deklaratën noteriale datë 20.2.2015, subjekti ka deklaruar se është dakord që kjo kontratë e lidhur midis tij dhe OSHEE-së të lidhet midis OSHEE-së dhe z. G.D. Në datën 27.8.2021 është bërë përsëri ndryshimi i emrit nga G.D në Urim Buci. Në lidhje me këtë kontratë, subjekti ka sqaruar se: *“Punonjësit e OSHEE-së, dega K., në fillim kanë bërë një ngatërresë, duke e vënë këtë kontratë në emër të dhëndrit tim G.G.D, ndërsa kontratën e katit të dytë banim në emrin tim Urim H. Buci. Aktualisht janë bërë ndryshimet përkatëse duke sistemuar kontratat sipas pronësisë faktike të kateve të objektit (kontratat e katit përdhe/njësi shërbimi dhe katit të parë banim në emrin tim Urim H. Buci, ndërsa kontrata e katit të dytë banim në emër të z. G.G.D)”*.

- Kontrata nr. ***, me kod klienti ***, është hapur në datën 20.4.2015 dhe në datën 27.8.2021 është bërë ndryshim emri nga Urim Buci në G.G.D. Kjo kontratë i përket katit të dytë banim.

2.15.3 Në kontratën e kredisë bankare datë 12.12.2014, përcjellë nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 7, adresa e shtetasit G.D si dorëzanes është: rruga “****”, banesë nr. ***, K.. Objekti ndodhet në kryqëzimin e rrugës “****” me rrugën “****”.

2.15.4 Rezulton e provuar gjithashtu se në datën 15.2.2015, me përpilimin e deklaratës noteriale, subjekti ka shprehur dakordësinë që kontrata e lidhur prej tij me OSHEE-në të lidhet midis OSHEE-së dhe z. G.D; kontrata midis z. G.D dhe UKK-së për furnizim me ujë është lidhur në datën 6.1.2016.

2.16 Komisioni pyeti subjektin⁴¹ nëse kati përdhe, i deklaruar prej tij si i ndërtuar për biznes është përdorur për aktivitet tregtar ose është dhënë me qira, nëse janë përfituar të ardhura nga përdorimi i tij dhe, nëse po, iu kërkua të sqarojë përdorimin e tij në vite, aktivitetin e kryer dhe të ardhurat e përfituara.

2.16.1 Në përgjigje, subjekti sqaroi se kati përdhe, njësi shërbimi ndërtuar për biznes, nuk është përdorur për aktivitet tregtar para datës 19.9.2022 dhe se ky ambient është dhënë me qira me afat 1-vjeçar për kopsht fëmijësh, për llogari të Bashkisë K., kontratë e lidhur në datën

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.10.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 20.10.2022); shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 6.2.2023); vërtetim debie nr. *** prot., datë 3.2.2023; dhe vërtetim debie nr. *** prot., datë 1.2.2023, përcjellë nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 6.

⁴¹ Pyetësor nr. 5.

19.9.2022. Kjo marrëdhënie qiraje është trajtuar në vijim të vendimit, në seksionin “gjetje të tjera”.

2.17 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se ka paqartësi në deklaratimet e subjektit në lidhje me kohën e investimit në objektin “godinë 3 kate e kombinuar”.

2.17.1 Pas dërgimit të barrës së provës, subjekti dha parashtrimet e tij lidhur me këtë konstatim, duke specifikuar edhe një herë kohën e fillimit të ndërtimit, ecurinë e tij dhe kohën kur ai vetë ka bërë investime në këtë ndërtim. Në lidhje me periudhën e ndërtimit të objektit, me prapësime ka shpjeguar: *“Kjo godinë banimi për të cilën Komisioni ka evidentuar pamundësi financiare dhe ka kaluar barrën e provës, është një pasuri faktike e krijuar para detyrës sime si prokuror dhe nuk afektohet nga interesat e mundshëm të krijuar gjatë detyrës së prokurorit, gjatë së cilës unë jam subjekt i rivlerësimit”*.

Vlerësimi i Komisionit

2.18 Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se:

- Objekti 3 kate i kombinuar ka nisur të ndërtohet pjesërisht në vitin 1996 dhe pjesa tjetër ka nisur të ndërtohet pas vitit 2008, pas marrjes së lejes së ndërtimit.
- Ky ndërtim, në situatën aktuale që është sot, sipas fotove të subjektit dhe ortofotove të konsultuara nga Komisioni, ka qenë i tillë deri në vitin 2015, pra nuk rezultojnë investime të kryera nga subjekti pas marrjes së detyrës si prokuror.
- Rezultoi e provuar se kati i dytë teknik i objektit disponohet nga z. G.D, i cili nga të dhënat indirekte të trajtuara më sipër rezulton se ka filluar të jetojë aty të paktën nga shkurti i vitit 2015. Nga hetimi nuk rezultoi që subjekti ta ketë përdorur katin përdhe për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

2.19 Lidhur me burimin e ligjshëm

2.19.1 Si në deklaratën *Vetting*, edhe në deklaratat e interesave periodikë privatë, subjekti ka deklaruar si burim konkretisht: *“Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë deklaruesi në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004”*.

2.19.2 Komisioni konstatoi se për të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez, në periudhën 2000 –2004, subjekti, gjatë deklaratimeve periodike dhe në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar as vlerë dhe as nuk depozitoi dokumentacion provues. Ai ka shpjeguar se⁴² nuk ka dokumentacion provues lidhur me periudhën e qëndrimit në Angli dhe si provë shkresore ka depozituar formularin e dekriminalizimit të plotësuar në momentin e marrjes së detyrës, në të cilin ka deklaruar se prej tetorit 2000 deri në qershor 2004 ka qëndruar në adresën: ***, D*** House, K***, Birmingham, UK. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5 ka deklaruar punët që ka kryer në Angli, si dhe adresat përkatëse të vendeve të punës, por sërish pa dokumentacion provues.

2.19.3 Gjatë procesit⁴³, subjekti u pyet për vlerën e të ardhurave të fituara nga emigracioni, për të cilat u përgjigj se ishin në shumën 60,000 GBP. Kjo vlerë nuk është deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike të subjektit dhe as në *Vetting*. Me pyetësorin nr. 8 iu kërkuan shpjegime për arsyen e mosdeklarimit të saj dhe ai shpjegoi se të ardhurat, përveç atyre që ka shpenzuar për nevojat e tij personale, i ka dërguar në Shqipëri pjesë-pjesë, sipas rastit, nëpërmjet shokëve

⁴² Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 6.9.2016.

⁴³ Shihni pyetësorin nr. 7.

të tij që ishin me dokumente të rregullta gjatë viteve 2001 – 2004 dhe ia kanë dorëzuar sipas traditës shqiptare familjes së tij, konkretisht nënës së tij Znj. M.B, pasi vëllai i tij D.B ka pasur probleme shëndetësore dhe babai i tij H.B ka qenë i sëmurë. Sipas shpjegimeve të subjektit nëna e tij ka luajtur rolin e kryefamiljares dhe një pjesë i ka shpenzuar për nevojat e familjes. Në vitin 2008, ai shpjegon se mori lejen e ndërtimit për të ndërtuar shtëpinë dhe nëna i dha një pjesë të këtyre parave që i kishte ruajtur vetë, për të ndërtuar shtëpinë. Pra, unë subjekti thekson se nuk i kam deklaruar këto para në deklaraten e vitit 2005, sepse i kishte nëna e tij në administrim dhe posedim si kryefamiljare pasi ai ka deklaruar në vitin 2005 vetëm gjendjen personale të tij dhe jo të nënës dhe familjarëve të tjerë. Në këtë mënyrë e ka kuptuar mënyrën e deklarimit në atë kohë, pa pasur asnjë qëllim dhe arsye për të mos i deklaruar.

2.19.4 Trupi gjykues duke qënë se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor marrjen e të ardhurave dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë hartoi analizën financiare për periudhën 1.7.2005 – 31.10.2015. Në analizë nuk janë përfshirë kosto ose investim në ndërtimin e godinës të kombinuar 3 kate, pasi subjekti gjatë gjithë deklarimeve të veta ka shpjeguar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni i tij në shtetin anglez dhe jo të ardhura të periudhës me burim pagat etj.

Vitet	Analiza financiare akumulative 1.7.2005 – 31.10.2015
TË ARDHURAT	9,450,165 lekë
Të ardhura nga paga si OPGJ prej korrikut 2005 (të dhëna prej RBAL Bank + vërtetim nga institucionet)	7,130,565 lekë
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	2,319,600 lekë
PASURIA	292,097 lekë
Blerja e automjetit tip “Golf”	280,220 lekë
Ndryshimi i likuiditeteve në sistemin bankar	145,725 lekë
SHPENZIMET	6,575,787 lekë
Shpenzime jetike për 2 anëtarë të familjes deri më 1.6.2006 dhe më pas për 3 anëtarë. Ndërsa prej gushtit 2009 me 4 anëtarë	5,512,781 lekë
Shpenzime të deklaruara në pyetësorin nr. 2 për pajisjen me leje ndërtimi	400,000 lekë
Shpenzime interesi për kredinë konsumatore pranë RBAL, datë 10.9.2007, vlera 1,000,000 lekë	73,006 lekë
Shpenzime për udhëtim nga qyteti i Tiranës drejt Fierit dhe anasjelltas, në funksion të detyrës si OPGJ (sipas pyetësorit nr. 2)	90,000 lekë
Shpenzime mobilimi sipas pyetësorit nr. 2	500,000 lekë
Rezultati financiar	2,519,384 lekë

Sa më lart, rezultoi se gjatë periudhës korrik 2005 – tetor 2015 subjekti do të mund të kursente vlerën 2,519,384 lekë.

2.19.5 Në përfundim, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare në vlerën totale të investimit të kryer prej tij prej 7,514,635 lekësh, pasi nuk arriti të provojë të ardhurat nga emigracioni, të cilat i ka deklaruar si burim për këtë ndërtim.

2.20 Në lidhje me investimin e kryer nga z. G.D në katin e tretë

2.20.1 Nga analiza e komisionit duket se përfundimi i ndërtimit në katin e tretë në gjithë sipërfaqen 185.15 m² është kryer gjatë viteve 2010 – 2015. Në bazë të deklarimeve të subjektit

në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 7, Komisioni çmoi se për punimet e kryera nga z. G.D në katin e tretë të ndërtesës (ose kati i dytë i banimit) janë pasqyruar në tabelë si vijon:

	Sip. m ²	Viti i ndërtimit	EKB – kosto ndërtimi	Investimi me kosto EKB	TVSH + fondi i fitimit (25%)	Kosto për çdo kat, zbritur TVSH dhe fondi i fitimit
Kati i dytë i banimit	62.55 + 122.6	Përfundimi i ndërtimit nga z. G.D në vitet 2010 – 2015	55,6% e EKB-së të mesatare të viteve 2010 – 2015	3,677,533	919,383	2,758,150

2.20.2 Vlera e investuar nga z. G.D gjatë periudhës 2010 – 2015 ka qenë 2,758,150 lekë. Me pyetësorin nr. 7 subjekti përcolli shtojcën nr. 2 të aktkonstatimit datë 23.11.2022, në të cilin shpjegon punimet e kryera nga z. G.D pas vitit 2015, punime të cilat janë kryer gjatë vitit 2020 dhe në këtë shtojcë deklarohet vlera 630,000 lekë për veshje fasade termoizoluese (sistem kapotë) dhe rifiniturë me grafiato me vlerë 234,000 lekë për hidroizolim tarrace me dy duar katrama, vlerë totale 864,000 lekë.

2.20.3 Komisioni hetoi edhe mundësinë financiare të z. G.D dhe familjarëve për të kryer këto punime dhe, në bazë të informacionit të përcjellë, kreu analizën financiare të tij, e cila është pasqyruar në tabelën si vijon:

Vitet	Analiza akumulative 2013 – 2020
TË ARDHURAT	9 890 122 lekë
Të ardhura nga paga e z. G.D	736 952 lekë
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	4 578 234 lekë
Të ardhura nga paga e G.D	3 927 526 lekë
Të ardhura nga paga e A.D	647 410 lekë
SHPENZIMET	7 043 032 lekë
Shpenzime jetike për 4 anëtarë	7 043 032 lekë
Rezultati financiar	2 847 090 lekë

2.20.4 Në analizë u përfshinë vetëm të ardhurat nga pagat e familjarëve, të cilat janë përcjellë në Komision nga ISSH-ja⁴⁴. Gjithashtu, në llogaritjet e burimit të të ardhurave për kryerjen e investimit është marrë në konsideratë edhe kredia në BKT nga znj. N.D, me qëllim rregullim apartamenti në dhjetor 2014, kontrata e së cilës është përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 7.

2.20.5 Në përmbledhje të sa më lart, rezultoi se investimi i kryer nga z. G.D në objekt ka qenë në total në vlerën 3,622,150 lekë⁴⁵, ndërsa vlera totale e rezultatit financiar (sa më lart në tabelë) dhe vlera e kredisë bankare pranë BKT-së është 3,847,090 lekë.

2.20.6 Në përfundim, trupi gjykues konstatoi se shtetasi G.D ka pasur mundësi të investojë në objektin “godinë 3 kate e kombinuar”, me të ardhura të ligjshme.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 28.2.2023.

⁴⁵ Rezulton vlera e shpjeguar në shtojcën nr. 2 të aktkonstatimit, datë 23.11.2022 (bashkëlidhur pyetësori nr. 7), 864,000 lekë + vlerën e rezultuar nga llogaritjet e Komisionit për ndërtimin e katit të 2-të banimi 2,758,150 lekë.

2.20.7 Në përfundim, në analizë të provave të administruara, trupi gjykues i dërgoi subjektit barrën e provës, sa vijon:

- Subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* për të ardhurat nga emigracioni në Angli në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2005.
- Subjekti ka pamundësi financiare prej 7,514,635 lekë për ndërtimin e objektit me të ardhurat nga emigracioni.

2.21 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare sa u përket konkluzioneve si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

2.22 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi në Komision prapësime/shpjegime të shoqëruara me dokumentacion.

2.22.1 Subjekti shpjegoi se burimet e të ardhurave për ndërtimin e objektit “godinë e kombinuar 3 kate”, për pjesët e tij, janë nga emigracioni në Angli në vitet 2000 – 2004. Paratë e kursyera prej tij janë dërguar me Western Union dhe nëpërmjet të njohurve apo shokëve të tij.

2.22.2 Ai ka sqaruar se: *“...unë subjekti Urim H. Buci jam në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacionin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë (godinë e kombinuar 3 kate, për pjesën time takuese) me të ardhura nga emigracioni në shtetin anglez gjatë viteve 2000–2004, prandaj ju lutem, pasi të krijoni bindjen e brendshme, t’i referoheni nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’”.*

2.22.3 Shpjegimet më të detajuara të subjektit në lidhje me të ardhurat nga emigracioni në Angli, punët që ka kryer atje, deklaratat noteriale të shtetasve me të cilët ka punuar, shkresën e Western Union në lidhje me pamundësinë për të vërtetuar dërgesat e parave nga subjekti nëpërmjet këtij institucioni financiar janë trajtuar tek pasuria nr. 1 tokë arë (më lart), meqenëse këto pasuri kanë të njëjtin burim.

2.22.4 Me prapësimet, subjekti përcolli në Komision analizën e tij për investimin e kryer prej tij në objekt. Në sqarimet e tij, subjekti i rivlerësimit përcolli sërish informacionin e vënë në dispozicion të Komisionit me pyetësorët gjatë procesit të rivlerësimit dhe me aktkonstatimin e datës 23.11.2022.

2.23 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

2.24 Lidhur me përlllogaritjen nga Komisioni të vlerës së investimit të kryer, Komisioni u është referuar sipërfaqeve që rezultuan nga praktika e ALUIZNI-t, përcjellë nga subjekti për legalizim, si dhe referencave në çmimet e EKB-së.

2.25 Rezultoi e provuar se ndërtimi i këtij objekti ka nisur në vitin 1996 (nga vëllai i subjektit, z. D.B) dhe është në gjendjen aktuale që prej vitit 2015. Pra, nuk ka prova që të provojnë kryerjen e këtij investimi pas fillimit të detyrës si prokuror. Kjo përputhet edhe me deklaratimet

e bëra nga subjekti për këtë pasuri si në vitin 2005, ashtu edhe në deklaratën para fillimit të detyrës. Nga hetimi rezultoi e provuar se deklarimi që subjekti ka bërë për burimin e krijimit të kësaj pasurie ka qenë koherent, të ardhurat nga emigracioni në Angli. Gjithashtu, rezultoi e provuar se subjekti ka qenë në emigracion dhe këtë fakt e ka deklaruar edhe si detyrim të ligjit për dekriminalizimin.

2.26 Është gjithashtu e provuar se subjekti nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë se këto të ardhura të deklaruara janë të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Ai ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentacion që vërteton transfertat e shumave monetare nga Anglia në Shqipëri gjatë kohës kur ishte emigrant, shuma të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në fjalë, por nuk ka mundur t'i sigurojë ato

2.27 Komisioni vlerëson se një situatë e tillë e vë trupin gjykues para një vështirësie për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij dhe të burimeve të ligjshme të të ardhurave për krijimin e pasurisë së përkrahur më lart, e cila rezultoi të jetë krijuar prej vitit 1996, kur ai ishte ende student deri në vitin 2015, kohë kur ai është emëruar prokuror.

2.28 Komisioni vlerëson në lidhje me pasurinë e subjektit të rivlerësimit në një optikë të përgjithshme, sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës të “shpjegimit bindshëm” të pasurisë, duke zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit në kuptim të parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili obligon organet e rivlerësimit që në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e të shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti, duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme.

2.29 Komisioni vlerëson se analiza e fakteve nën dritën e këtyre parimeve është e arsyeshme, se subjekti i rivlerësimit duket se ka dështuar të provojë në mënyrë të plotë të ardhurat e tij nga emigracioni të cilat kanë shërbyer për financimin e pasurisë së tij të vetme.

Bazuar edhe në parimin e objektivitetit, i cili parashikohet nga neni 14 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”*, Komisioni vlerësoi se të gjitha rrethanat, në mënyrë thelbësore lidhen me faktin se subjekti provon që ka qenë në Angli për periudhën 2000 – 2004.

2.30 Krahas arsytimit të mësipërm, Komisioni pati në konsideratë në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën disa rrethana, si deklarimin e qenies së tij në emigracion në deklaratën për dekriminalizimin, deklarimin koherent në DIPP-në e vitit 2005, si dhe të asaj para detyrë të burimit të të ardhurave të kësaj pasurie, faktin që kjo pasuri është vënë shumë kohë para fillimit të detyrës si prokuror dhe faktin që nuk ka asnjë të dhënë që ai të ketë krijuar pasuri apo likuiditete pas detyrës si prokuror.

2.31 Komisioni vlerësoi rrethanat e analizuara më sipër në harmoni dhe në raport me të gjitha çështjet e tjera, të cilat u trajtuan në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në dritën e parimit të proporcionalitetit, parashikuar në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e*

arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë”.

2.32 Në kuptim të parashikimit të mësipërm, Komisioni vlerëson se mungesa e provimit të të ardhurave prej emigracionit, nën dritën e rrethanave të analizuara me objektivitet si më lart, edhe pse subjekti nuk konsiderohet nga vlerësimi i trupit gjykues se gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se nuk rezultojnë të provohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e kësaj dispozite, nuk përbën element të mjaftueshëm për vendosjen e masës së shkarkimit të subjektit.

2.33 Në mungesë të ndonjë të dhëne që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit me deklarinimin e të ardhurave të tilla ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, trupi gjykues, nisur dhe nga fakti që pasuria rezultojnë të jetë krijuar dhe ekzistuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruar në detyrën e prokurorit, çmon se kjo situatë faktike nuk është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt, i cili të prodhojë pasoja për subjektin e rivlerësimit, vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. Kjo mangësi, duke qenë se është e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se ajo mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

2.34 Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje me endimin nr. 6, datë 17.3.2022 me vendimin nr. 6, datë 17.3.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

2.35 Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga emigracioni, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa **⁴⁶, nr. shasië ***, vit prodhimi 2001.** Burimi i krijimit: të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes ndër vite. Vlera: 2,000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 4.6.2014, notere SH.GJ, Tiranë.

Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

3.1 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në para fillimit të detyrës, në vitin 2015.

3.2 Me kontratën e sipërpërmendur të referuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka blerë këtë automjet në datën 4.6.2014 nga shitësi D.SH.P, kundrejt vlerës 2,000 euro⁴⁷.

3.3 Mjeti është importuar nga Italia, importues dhe eksportues ka qenë z. D.P⁴⁸. Çmimi i mjetit të importuar ka qenë 150,000 lekë + taksat 34,341 lekë, çmimi total 184,341 lekë.

⁴⁶ Duket se ka një gabim material në deklarinimin e numrit të targës. Referuar shkresës së DPSHTRR-së dhe shasisë, si dhe shpjegimeve të dhëna në formularin standard, targa është ***.

⁴⁷ Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁸ Shihni aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet e dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2021).

3.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti ka deklaruar: *“Të ardhurat për blerjen e këtij automjeti janë siguruar nga paga ime dhe e bashkëshortes sime ndër vite”*. Komisioni kreu analizën financiare në tabelën si vijon:

Analiza financiare	2013	1.1.2014 - 4.6.2014	Analiza financiare 2013 – 4.6.2014
Të ardhura nga paga e subjektit si OPGJ	711 391 lekë	419 729 lekë	1 131 120 lekë
Të ardhura nga paga pranë AKBN-së së bashkëshortes	391 683 lekë	220 356 lekë	612 039 lekë
Vlera e blerjes së automjetit tip “Volkswagen”		280 220 lekë	280 220 lekë
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë	2 315 lekë	29 575 lekë	31 890 lekë
Shpenzimet jetike për 4 anëtarë	564 096 lekë	366 663 lekë	930 759 lekë
Rezultati financiar	536 663 lekë	- 36 373 lekë	500 290 lekë

3.5 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin për pasurinë; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

4. Llogari page në “Credins Bank”, gjendje në momentin e deklarimit.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Vlera: 192,64 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

4.1 “Credins Bank” konfirmoi⁴⁹ se gjendja në datën e deklarimit 26.1.2017 është -100,807 lekë. Ka mospërputhje të vlerës së deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* me konfirmimin e “Credins Bank”.

4.2 Kjo llogari është hapur nga subjekti i rivlerësimit në datën 5.1.2010 dhe në të transferohen pagat, fillimisht si OPGJ dhe më pas paga si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Dibër.

4.3 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë likuiditet.

5. Gjendje cash në banesë në vlerën 780,000 lekë, me pjesë takuese 100%. Burimi i krijimit: *“Të ardhura nga pagat si Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Tiranë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë (2005 – 2015), prokuror në Prokurorinë e Rrethit Dibër (2.11.2015 - 31.12.2015), si dhe paga e bashkëshortes pranë kompanisë ‘A.G’ sh.p.k., Tiranë dhe pranë AKBN-së (2010 – 2015)”*.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

5.1 Në DIPP-në para fillimit të detyrës (viti 2015), subjekti ka deklaruar *cash* në banesë në vlerën 1,200,000 lekë, me pjesë takuese 100%. Si burim të kësaj vlere ka deklaruar të njëjtin burim si në deklaratën *Vetting* (të sipërcituara).

5.2 Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vlerën 780,000 lekë, me të njëjtin burim si më lart dhe me shpjegimin: *“Nga shuma 1,200,000 lekë para fillimit të detyrës,*

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021.

është zbritur shuma 420.000 lekë të shpenzuara për blerjen e makinës së bashkëshortes”. Në DIPP-të e viteve pasardhëse nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të vlerës *cash*.

5.3 Lidhur me burimin e ligjshëm: subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga si OPGJ (korrik 2005 – tetor 2015) dhe paga e bashkëshortes pranë shoqërisë “A.G” sh.p.k. dhe pranë AKBN-së. Për sa deklaruar nga subjekti, u krye analiza financiare për periudhën korrik 2005 – tetor 2015, duke mos përfshirë në analizë investimin në godinën e trajtuar më lart, të cilin e deklaroi me burim të ardhurat e tij nga emigracioni.

Analiza financiare	Analiza financiare akumulative 1.7.2005 - 31.10.2015
Të ARDHURAT	9,450,165 lekë
Të ardhura nga paga si OPGJ prej muajit korrik 2005	7,130,565 lekë
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	2,319,600 lekë
Pasuri	292 097 lekë
Blerja e automjetit tip “Golf” në qershor 2014	280 220 lekë
Ndryshimi i likuiditeteve në sistemin bankar	145 725 lekë
SHPENZIMET	6 575 787 lekë
Shpenzime jetike ⁵⁰	5,512,781 lekë
Shpenzime të deklaruara në pyetësonin nr. 2, për pajisjen me leje ndërtimi	400,000 lekë
Shpenzime interesi për kredinë konsumatore pranë RBAL datë 10.9.2007, vlera 1,000,000 lekë.	73,006 lekë
Shpenzime për udhëtim nga qyteti i Tiranës drejt Fierit dhe anasjelltas, në funksion të detyrës si OPGJ (pyetëson nr. 2)	90,000 lekë
Shpenzime mobilimi sipas pyetësonit nr. 2	500,000 lekë
Rezultati financiar	2,519,384 lekë

5.4 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin likuiditetin *cash*; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme të krijojë vlerën 1,200,000 lekë të kursimeve *cash* para fillimit të detyrës, me të ardhura të ligjshme.

Pasuri të personit të lidhur të subjektit (bashkëshortes)

6. Automjet tip “Daimler Chrysler168”, ngjyrë gri, vit prodhimi 2003, naftë, nr. shasie ***, në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. S.B. Kjo pasuri është fituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 30.11.2015, përpiluar para noterit L.V.

Vlera: 3,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Si burim i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie, në deklaratën *Vetting* janë deklaruar të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij ndër vite.

⁵⁰ Shpenzime jetike për 2 anëtarë të familjes deri më 1.6.2006 dhe më pas për 3 anëtarë. Ndërsa prej muajit gusht 2009 me 4 anëtarë.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

6.1 Blerja e kësaj pasurie është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2015, me burim “cash në shtëpi”.

6.2 Personi i lidhur i subjektit, znj. S.B⁵¹, e ka blerë këtë automjet në datën 30.11.2015 me kontratën e deklaruar në deklaratën *Vetting* (të sipërpërmendur) nga shitësi L.GJ, kundrejt çmimit 3,000 euro. Ky i fundit e kishte blerë automjetin në Gjermani kundrejt vlerës 1,000 euro, plus taksa 32,244 lekë. Automjeti është regjistruar në pronësi të personit të lidhur të subjektit, me targë ***.

6.3 Komisioni hetoi në lidhje me ekzistencën e një konflikti të mundshëm interesi me shitësin e automjetit L.GJ dhe nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar çështje, ku shitësi të ketë qenë pjesëmarrës me çfarëdolloj cilësie⁵².

6.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 se si burim për automjetin në pronësi të bashkëshortes kanë shërbyer: *“Të ardhurat nga pagat si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, Tiranë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë (2005 – 2015) dhe paga e bashkëshortes sime pranë kompanisë ‘A.G’ sh.p.k., Tiranë dhe pranë AKBN-së (2010–2015). Nga shuma 1,200,000 lekë para fillimit të detyrës është zbritur shuma 420,000 lekë të shpenzuara për blerjen e makinës së bashkëshortes”*. Subjekti ka deklaruar se si burim i krijimit është pakësimi i gjendjes së kursimeve cash të krijuara para detyre. Deklarimi i këtij burimi të krijimit të kësaj pasurie është bërë në DIPP-në e vitit 2015 dhe i referohet deklaramit të gjendjes cash të kursimeve në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, në vlerën 1,200,000 lekë.

Mundësia financiare dhe burimi i krijimit të gjendjes cash të kursimeve është trajtuar më lart në pasurinë “cash në banesë”.

6.5 Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri me të ardhura të ligjshme.

7. Llogari page e bashkëshortes, znj. S.B, në “Credins Bank”, gjendje në momentin e deklaramit.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga si specialiste pranë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Tiranë. Vlera: 44,89 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni

7.1 “Credins Bank” ka konfirmuar⁵³ se gjendja në datën e deklaramit 26.1.2017 është 44,89 lekë.

⁵¹ Aneks nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2021).

⁵² Shkresat e administruara në Komision me nr. *** prot., datë 5.12.2022; nr. *** prot., datë 16.12.2022; dhe nr. *** prot., datë 23.12.2022, dërguar përkatësisht nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore Kurbin, Vlorë dhe Fier.

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 18.3.2021.

Kjo llogari është hapur nga personi i lidhur në datën 27.7.2012, ku janë transferuar pagat nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore. Gjithashtu, nga kjo llogari janë kryer edhe transfertat për pagesat e kartës së kreditit të personit të lidhur pranë “Credins Bank”.

7.2 Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë likuiditet.

GJETJE TË TJERA

8. Me qëllim realizimin e një hetimi të plotë e gjithëpërfshirës, subjekti informoi Komisionin se kati përdhe i objektit 3-katësh, njësi shërbimi i ndërtuar për biznes, nuk është përdorur për biznes para datës 19.9.2022 dhe në këtë datë, pra më 19.9.2022, “...*ky ambient është dhënë me qira me afat njëvjeçar për kopsht fëmijësh për llogari të Bashkisë K.. Për këtë është lidhur edhe kontrata e qirasë me nr. *** prot., datë 19.9.2022, me vlerë mujore 95,000 lekë. Nga kjo qira ende nuk janë përfituar të ardhura në llogarinë time bankare*”. Sipas kontratës (neni 1), lidhur nga vetë ai si qiradhënës, me përfaqësuesen e Bashkisë K., zv/Kryetaren e Bashkisë, znj. U.E, Bashkia K., e ka marrë objektin me qira *me qëllim përdorimin për kopshtin nr. *** “K”, sipas detyrave që kjo e fundit ka në realizimin e detyrave të saj funksionale, duke pasur parasysh funksionin e këtyre ambienteve objekt kontrate.*

8.1 Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Bashkia K.⁵⁴, rezulton se kjo e fundit kërkesën për marrje ambientesh me qira e ka publikuar në faqen zyrtare <https://kamza.gov.al>. Grupi i Punës, i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë⁵⁵, ka bërë përzgjedhjen e ofertës fituese dhe pas përzgjedhjes është lidhur kontrata e sipërpërmendur.

8.2 Në kuadër të procesit të rivlerësimit, Komisioni e vlerësoi këtë marrëdhënie qiraje në bazë të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, pika 1 e nenit 21 të këtij ligji, ku parashikohet se: “*1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 i këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik. Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues të parashikuar në nenin 31 dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 i këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë, vlerësoi ekzistencën e konfliktit të interesit për subjektin*”.

8.3 Nga analiza e provave dhe e fakteve duket se subjekti ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, duke lidhur me Bashkinë K. një kontratë qiraje për pasurinë e tij, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. Për sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë situatë në dukje në konflikt interesi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 24.2.2023).

⁵⁵ Urdhër nr.***, datë 12.9.2022.

8.4 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti parashtrroi se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për këtë kontratë, duke shpjeguar se: *“Në nenin 4, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’, i ndryshuar, parashikohet se: 1. Dispozitat e këtij ligji përcaktojnë rregulla të detyrueshme për t’u zbatuar nga: a) çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për: i) akte dhe kontrata administrative; ii) akte të organeve gjyqësore, noteriale, për ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga organet e përmbarimit dhe akte të organeve të prokurorisë; iii) akte normative, si dhe vetëm ato ligje që krijojnë pasoja juridike për subjekte individualisht të përcaktuara...”.* Referuar kësaj dispozite ligjore kuptohet qartë se kontrata e qirasë që kam lidhur me Bashkinë K. nuk është një akt administrativ apo kontratë administrative, por është një kontratë civile që lidhet sipas dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër, unë ushtror funksionet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që nuk ushtron kompetencat tokësore në territorin e Bashkisë K., që mund të përbënte në dukje konflikt interesi”.

8.5 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

8.6 Komisioni vlerësoi se pretendimi i subjektit që kjo kontratë qiraje është kontratë civile dhe jo kontratë administrative, është i pabazuar në ligj. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në pikën 4 të nenit 3 të tij përcakton se: *“Kontrata administrative është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas të drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik”.* Bazuar në këtë përkufizim që ligji i bën kontratës publike, duke pasur parasysh që palë në këtë kontratë është Bashkia K., pra një institucion publik, i përfaqësuar nga kryetari i bashkisë si organi ekzekutiv i tij, Komisioni vlerëson se kontrata në fjalë është kontratë publike, pavarësisht se modalitetet e saj, referuar bazës ligjore të saj, janë rregulluar sipas dispozitave të Kodit Civil.

8.7 Megjithatë, pavarësisht nga fakti që kjo kontratë u vlerësua nga Komisioni si kontratë publike, Komisioni analizoi ndalimin e sipërpërmendur të parashikuar nga pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në raport me përcaktimet e pikës 4 të kësaj dispozite, si dhe në raport me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

8.8 Neni 4 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, krahas ndalimit në pikën 1, në pikën 4 të tij ka parashikuar rastet përjashtimore nga ky ndalim, pra rastet kur ky ndalim nuk zbatohet. Konkretisht, në këtë pikë parashikohet që: *“...nga ndalimet e pikave 1,2 dhe 3 përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës: d) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve; [...]”.*

8.9 Për të vlerësuar nëse kontrata e qirasë e lidhur midis subjektit dhe Bashkisë K. është kontratë e lidhur për qëllime publike që përjashtohet nga ndalimet e kësaj dispozite, Komisioni iu referua ligjit që përcakton funksionet, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky ligj parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë, ndër të tjera, të drejtën për të lidhur kontrata (neni 9,

pika 1.6, germa “a”) dhe bashkia në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ka ndër të tjera funksion të saj: *“11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale. 12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”*⁵⁶.

8.10 E parë në raport me këto përcaktime të ligjit nr. 139/2015 dhe me qëllimin e ligjvënësit për të trajtuar në mënyrë të diferencuar kontratat që kanë qëllime publike, duke pasur parasysh se administrimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe infrastruktura arsimore parauniversitare janë funksion i bashkisë i kategorizuar nga ligji si shërbim publik, trupi gjykues vlerësoi se kontrata e lidhur midis subjektit dhe Bashkisë K., me të cilën kjo bashki ka marrë me qira ambientin në pronësi të subjektit për ta përdorur si kopsht për fëmijë, është kontratë e lidhur për qëllime publike dhe, si e tillë, bën pjesë në rastet që përjashtohen nga ndalimi i pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, që do ta vendoste subjektin në situatën e konfliktit të interesit.

8.11 Për të arritur në këtë konkluzion në lidhje me konfliktin e interesit, trupi gjykues mbajti në konsideratë gjithashtu edhe faktin që subjekti e ushtron funksionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, pra jo në territorin ku është lidhur dhe ka sjellë efektet kjo kontratë.

8.12 Gjithashtu, në këtë vlerësim, trupi gjykues mori në konsideratë edhe faktin se kjo kontratë nuk është lidhur sipas dispozitave të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”. Ky ligj në nenin 7 të tij përcakton përjashtimet e veçanta nga zbatimi i tij dhe sipas germës “a” të këtij neni, ky ligj nuk zbatohet për kontratat publike për *blerjen ose qiranë me çdo mjet financiar të tokës, të ndërtesave ekzistuese ose të pasurive të tjera të paluajtshme apo të të drejtave mbi to*.

8.13 Në përfundim, pasi analizoi faktet, dokumentet dhe përcaktimet ligjore si më lart, trupi gjykues çmoi se subjekti në lidhjen e kontratës së qirasë nuk ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit.

ANALIZA FINANCIARE

9. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare

9.1 Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare, është bazuar në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme dhe likuiditete), si dhe shpenzimet e kryera.

9.2 Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në:

⁵⁶ Pikat 11 dhe 12 të nenit 23 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

9.2.1 Të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat në vlerë *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁵⁷, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

9.2.2 Shpenzimet në objektin e kombinuar 3 kate përfshijnë shpenzimet që subjekti i ka deklaruar në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 7 si të kryera gjatë vitit 2015. Duke qenë të një natyre të pidentifikueshme, Komisioni, në bazë të parimit të proporcionalitetit, ka bërë shpërndarjen e gjithë vlerës së investuar në vitin 2015 në çdo muaj, duke përfshirë në analizë vetëm 2 muaj (nëntor – dhjetor 2015), pasi subjekti ka marrë detyrën si prokuror. Konkretisht, vlera e këtij zëri në analizë përfshin 2 muaj nga: (a) 55.6% të vlerës së katit të parë banim në godinën ekzistuese me vlerë 139,603 lekë; (b) 55.6% të vlerës së katit përdhe godina me leje me vlerë 247,959 lekë; (c) 55.6% të vlerës së katit të parë të banimit në godinën me leje, por vetëm për sipërfaqen 37.45 m² (185.15 m² – 100 m²), me vlerë 83,583 lekë.

9.2.3 Shpenzimet për vendosjen e dritareve në katin e parë banim deklarohen nga subjekti në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 7, duke shpjeguar se ato janë kryer prej tij dhe vlera e tyre është përfshirë në situacionin e punimeve të përcjellë me pyetësorin nr. 2, datë 23.11.2022. Vlera totale e këtyre punimeve në situacion është 642,000 lekë. Komisioni përfshiu në analizë këto shpenzime sipas deklarimeve të subjektit.

9.2.4 Shpenzimet e jetesës u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Në llogaritjen e shpenzimeve jetike në analizën financiare është përfshirë numri i anëtarëve të familjes për të cilët trajtimi i shpenzimeve jetike është bërë në bazë të deklaramit të subjektit në pyetësorin standard, por duke u mbështetur edhe në gjendjen familjare sipas certifikatave të gjendjes civile. Pra, prej marrjes së detyrës, nëntor 2015 deri në dhjetor 2016, shpenzimet jetike janë llogaritur si familje me katër anëtarë.

9.2.5 Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, si dhe në deklaramit e subjektit⁵⁸. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaramit e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit, kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, janë konsideruar vetëm shpenzimet minimale prej 5 euro si shpenzime ditore dhe nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklaramin e tij. Në rastet e tjera, kur deklaramit e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit. Për udhëtimet ditore, vajtje-ardhje brenda ditës, janë konsideruar vetëm shpenzimet e udhëtimit dhe 5 euro si shpenzime ditore.

9.2.6 Shpenzimet për blerje automjesh⁵⁹ u bazuan në deklaramit vjetore të subjektit, pyetësorët, si dhe në dokumentacionin përkatës.

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 18.7.2017, të ISSH-së, aneks 35 ILDKPKI dhe vërtetim nga A.G, datë 24.1.2017, aneks 4/9 dosja ILDKPKI-ja dhe shkresa nr. *** prot., datë 3.3.2017, e ISSH-së dosja e hetimit. Vërtetimet e institucioneve punëdhënëse të përcjella me deklaramitën *Vetting* në aneks 4/9.

⁵⁸ Përgjigjet e pyetësorit standard.

⁵⁹ Shihni aneksin nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet e dosjes së dërguar nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. *** prot., datë 2.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.3.2021).

9.2.7 Personi i lidhur deklaroi kartë krediti pranë “Credins Bank”, me vlerë -54,277.04 lekë, e cila konfirmohet prej kësaj banke. Gjithashtu, informohet se kjo kartë është hapur në datën 4.2.2013 me vlerë 100,000 lekë dhe është përdorur për blerje të vogla kryesisht brenda, por edhe jashtë vendit. Në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* gjendja e kartës së kreditit ka qenë -94,683 lekë.

9.2.8 Subjekti deklaroi në deklaratën *Vetting overdraft* në llogarinë rrjedhëse të pagës në “Credins Bank”, në vlerën 110,000 lekë, kontratë e rilidhur përsëri në shkurt 2016. Vlera: -100,807.31 lekë. Nga shkresa e “Credins Bank” konfirmohet se në datën 12.1.2010 është transferuar shuma 100,470 lekë drejt “Raiffeisen Bank”, për shlyerje *overdrafti* pranë saj. Kjo vlerë nuk rezulton të kishte qenë gjendje në llogari deri në këtë datë. Pra, kuptohet se subjektit i është çelur në këtë moment limiti i *overdraftit*. Gjendja e llogarisë së pagës në datën e plotësimit të deklaratës është 100,807 lekë, pra përputhet me deklarinimin.

9.2.9 Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklarinimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë.

9.2.10 Gjendja e likuiditeteve⁶⁰ në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

9.3 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarinimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

10. Në përfundim, në analizë të provave të administruara, duket se subjekti për periudhën para fillimit të detyrës (deri më 31.10.2015) rezulton me pamundësi financiare me vlerë 6,427,592 lekë dhe për periudhën nëntor 2015 - 2016 (pasi është emëruar prokuror), rezulton me vlerë negative prej 745,142 lekësh.

11. Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare në lidhje me konkluzionet si më lart.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision prapësime dhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara në prapësimet e paraqitura me shkrim. Konkretisht, subjekti prapësoi si vijon:

12.1 Për periudhën përpara fillimit të detyrës deri më 31.10.2015

Sikurse u trajtua edhe më lart, subjekti shpjegoi se është në pamundësi objektive për të provuar të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez dhe kërkoi që në burimin e të ardhurave për ndërtimin e objektit para fillimit të detyrës, të llogariten edhe të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes.

Vlerësimi i Komisionit

⁶⁰ Shkresat: nr. *** prot., datë 18.3.2021, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 12.3.2021, nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 24.3.2021, nga BKT-ja; nr. *** prot., datë 25.3.2021, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

12.1.1 Komisioni nuk përfshiu në analizë të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes përpara fillimit të detyrës, pasi subjekti, si në deklaratën *Vetting* edhe në DIPFD 2015, ka deklaruar se burimi i të ardhurave për ndërtimin e objektit kanë qenë të ardhurat nga emigracioni dhe nuk ka deklaruar si burim të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes.

12.1.2 Vlera e balancës negative për këtë periudhë (para fillimit të detyrës) mbetet e pandryshuar.

12.1.3 Kjo balancë negative vjen për shkak të mospërfshirjes në analizën financiare të të ardhurave nga emigracioni para detyrës të cilat kanë qenë burim krijimi për ndërtimin e objektit-pasurisë nr. 2, të analizuar nga komisioni më lart. Vlerësimi i trupës gjykuese dhe analizimi i vlerës negative të analizës financiare para detyre është trajtuar me analizën e burimit të krijimit të pasurisë nr. 2, si më lart.

12.2 Për periudhën nëntor 2015 - 2016

12.2.1 Subjekti shpjegoi se vlera e kartës së kreditit të bashkëshortes së tij në vitin 2015 është vendosur saktë, por duhet të vendoset me plus në zërin e detyrimeve dhe jo me minus siç është përcjellë në analizën e Komisionit. Në këtë mënyrë, viti 2015 rezulton me vlerë pozitive, por gjithashtu efekti përcillet edhe në vitin 2016.

12.2.2. Subjekti, gjithashtu, pretendoi se për vitin 2016, në analizën financiare të dërguar me rezultate hetimi, ka një pasaktësi në lidhje me shpenzimet e kryera për dritaret e duraluminit, pasi vlera e tyre e përcjellë me përgjigjet e pyetësorit nr. 7 është 64,000 lekë dhe jo 642,000 lekë, siç është vendosur në analizë.

Vlerësimi i Komisionit

12.2.3 Trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e subjektit lidhur me kartën e kreditit qëndrojnë, pasi në analizën e komisionit detyrimet financiare pasqyrohen me vlerë pozitive, ndërsa rezultati financiar vjen nga zbritja e tyre prej të ardhurave të periudhës. Si rrjedhim, pas përditësimit të vlerës së kartës së kreditit të bashkëshortes, vlera e analizës financiare për periudhën nëntor 2015 - 2016 është minus 464,014 lekë nga vlera 745,142 lekë e përcjellë me rezultatet e hetimit.

12.2.4. Lidhur me shpenzimet për dritaret e duraluminit, duke qënë se Komisioni nuk ka ekspertizë nga specialistë të fushës për këtë çështje ka përfshirë në analizë vlerën e tyre të përcjellë nga subjekti me pyetësorin nr. 2. Specifikisht, në akt konstatimin e punimeve të datës 23.11.2022, zëri “vetratë duralumini” ka vlerën 480,000 lekë, ndërsa zëri “dritare duralumini” ka vlerën 162,000 lekë; pra, totali i dy zërave është 642,000 lekë. Trupi gjykues vlerëson se duke patur dy deklarime të ndryshme të subjektit për të njëjtin shpenzim do të përfshihet në analizën financiare të tij vlera e deklaruar prej tij në pyetësorë, kohë kur subjekti nuk ishte njohur ende me rezultatet e hetimit administrativ.

ANALIZA FINANCIARE

<i>Përshkrimi</i>	Para fillimit të detyrës 1.7.2005- 31.10.2015	Nëntor 2015	2016
PASURI	9,301,970	(181,311)	12,996
Tokë "Arë" me sipërfaqe 724 m2, +276 m2, adresa: K*. Vlera totale 400.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes dt.26.07.2007. Pjesa takuese 100%.	400,000		
Godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo. Kati i tretë i objektit është në posedim të G* D*. Burimi: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga subjekti në shtetin anglez gjatë viteve 2000-2004. Vlera 6.918.105 lekë .	7,514,635		
Autoveturë Volkswagen, tipi Golf. Burimi: Nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes ndër vite. Vlera 2.000 Euro, sipas kontratës dt.04.06.2014. Pjesa takuese 100%.	280,220		
Automjeti tip Daimler Chrysler, në pronësi të bashkëshortes. Vlera 3.000 Euro sipas kontratës së shitblerjes dt.30.11.2015. Pjesa takuese 100%.		412,950	
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	1,107,115	-594,261	12,996
Gjendje kursimesh cash	1,200,000	780,000	780,000
<i>Total likuiditete</i>	<i>1,274,773</i>	<i>680,512</i>	<i>693,508</i>
DETYRIME	0	101,855	(15,747)
Kartë krediti e bashkëshortes pranë C* Bank		101,855	- 15,747
PASURI NETO	9,301,970	(283,166)	28,743
TË ARDHURA të dokumentuara	9,450,165	471,813	1,649,185
Të ardhura nga paga si oficer i policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nga muaji korrik 2005 deri janar 2008.	7,130,565		
Të ardhura nga paga si OPGJ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.			
Të ardhura nga paga si Prokuror në Prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, nga muaji nëntor 2015 deri në 31.12.2016.		247,453	1,101,658
Të ardhura nga paga e bashkëshortes si punonjëse e shoqërisë "A* G*" shpk, nga korrik 2010 deri në muajin korrik 2012.	447,840		
Të ardhura nga paga e bashkëshortes si punonjëse konsulentë dhe specialiste pranë A*, nga muaji Korrik 2012 deri në dhjetor 2016.	1,871,760	224,360	547,527
SHPENZIME	6,575,787	660,181	2,084,456
Shpenzime udhëtimi në funksion të punës (T*-D*), pyetësor nr. 2		8,000	48,000
Shpenzime në objekt të realizuara në vitin 2015		471,144	
Shpenzime të deklaruara në pyetësor nr. 2 për marrjen e lejes së ndërtimit	400,000		
Shpenzime interesi për kredinë Konsumatore pranë R* dt.10.09.2007 vlera 1,000,000 leke.	73,006		
Shpenzime për udhëtim nga qyteti i T* drejt F* dhe anasjelltas, në funksion të detyrës si OPGJ-ë (sipas pyetësor nr. 2)	90,000		
Shpenzime mobilimi sipas pyetësor nr. 2	500,000		
Shpenzime për vendosjen e dritareve në katin e parë banim (pyetësor nr. 7 dhe nr. 2)			642,000
Shpenzime ndaj shkollës jo publike "P*" lidhur me shkollimin e fëmijëve			86,450
Shpenzime udhëtimi		31,520	367,638
Shpenzime jetese	5,512,781	149,517	940,368
Analiza dokumentuar	(6,427,592)	94,798	(464,014)

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

14. Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Subjekti nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.
- iii. Mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e një pasurie para detyre si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut të drejtësisë.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykoës vlerëson se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLI I FIGURËS

34. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, me shkresën nr. *** prot., datë 12.12.2022⁶¹, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Urim H. Buci, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2022, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

35. Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit Urim Buci: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

36. Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi nuk u gjet ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

⁶¹ Administruar në Komision me nr. *** prot., datë 14.12.2022.

37. Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin *indicie* për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

38. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është përgatit relacioni për vlerësimin e aftësive profesionale, në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

39. Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional (para fillimit të ushtrimit të këtij funksioni nga KLP-ja) për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar dhe depozituar në Komision me shkresën nr. ***, datë 19.9.2018 raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

39.1 Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriteret e mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

39.2 Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe nga arkivi i 23 prokurorëve të gjykatave të shkallës së parë.

40. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Urim Buci paraqet aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht bën referim të saktë dhe të drejtë të bazuar në normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi analizon normën penale të zbatueshme në raport me faktet dhe provat, duke bërë referime edhe në ligje të tjera që kanë lidhje me çështjen konkrete. Megjithatë, u gjetën edhe raste kur në akte të ndryshme gjenden mangësi në pasqyrimin në to të ndonjë elementi sqarues me të cilat aktet do të ishin më të qarta dhe më të lexueshme, si në përmbajtje ashtu edhe sa i përket organit të cilit i drejtohet akti. Megjithatë, vlerësohet se për periudhën e pakët si prokuror, subjekti i rivlerësimit duhet të vijojë me përmirësimin e mëtejshëm të tij.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Urim Buci, ka treguar kujdes në punën e tij duke nxjerrë në dukje se ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet, kërkesat dhe aktet e tjera të përpiluara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit procedural të prokurorit. Struktura e dokumenteve ligjore të tij u konstatua përgjithësisht e qëndrueshme, e mirorientuar, por në ndonjë rast jo plotësisht e standardizuar, bazuar në formularët standard në nivel prokurorie. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe analizon në tërësi rrethanat e faktit. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti i ka kushtuar rëndësi analizës së normave ligjore.

41. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Urim Buci, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit, për një periudhë nga nëntor 2015 e në vazhdim, konkretisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, që tregon se vlerësimi i tij bëhet për një periudhë 11-mujore. Në këtë periudhë ka hetuar e përfaqësuar në gjykim vepra penale, të cilat janë në kompetencë territoriale dhe lëndore të kësaj prokurorie.

Sa iu përket të dhënave statistikore, nga prokurori Urim Buci janë deklaruar 214 çështje të caktuara përgjatë viteve të tij në detyrën e prokurorit, 2015 - 2016.

Të përfunduara tri vitet e fundit, janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit 122 procedime penale dhe 92 kallëzime penale.

Lidhur me çështjet e mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës, prokurori Urim Buci ka deklaruar gjithsej 53 procedime penale dhe 12 kallëzime penale.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në kryerjen e funksionit, pasi përgjithësisht janë respektuar afatet hetimore dhe janë bërë përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. U konstatua një rast mosfillimi, i cili është marrë tej afatit 1-mujor, i përcaktuar në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Nga aktet e analizuara nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje të qëllimshme në kryerjen e veprimeve hetimore apo në kalimin për veprim të tyre tek shërbimet e policisë gjyqësore.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Urim Buci është eficient dhe efektiv në drejtim të kohës së hetimit.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit Urim Buci kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse dhe bazohen në provat e administruara dhe aktet e nevojshme duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë dhe nuk u konstatuan raste për pavlefshmëri të akteve të konstatuara në gjykatë apo të ankimuara nga palët e interesuara.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Nuk paraqiten mungesa në përmbajtjen formale të akteve. Në fashikuj përfshihen të gjitha aktet që i përkasin çdo çështjeje konkrete.

42. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short dhe 3 dokumenteve të përzgjedhura prej tij rezulton se, përgjithësisht, nga ana e prokurorit është përmbushur disiplina dhe angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Urim Buci dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Urim Buci. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi i tyre në gjykim. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të venë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Duke marrë parasysh të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Urim Buci të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

43. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Urim Buci me palët e tjera në proces dhe me gjykatën. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është përgjithësisht normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk dalin të dhëna të plota për mënyrën e bashkëpunimit të subjektit Urim Buci që të tregojë për aftësitë e tij për të punuar në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Urim H. Buci ka marrë titullin “Jurist” në datën 6.7.2000, në Universitetin e Tiranës. Ai ka paraqitur dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen e tij në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Hetimi i Komisionit

44. Pavarësisht raportit të dërguar, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre, u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentet 1 dhe 2 të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dosjet 4 e 5, të shortuara, si vijon:

44.1 Lidhur me dokumentin 1, në kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, u vu re si mangësi mospërmendja e gjykatës së cilës i drejtohet kërkesa, ku duhej shënuar “drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”.

44.2 Lidhur me dokumentin 2, që i përket vendimit “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, datë 25.4.2016, u konstatua se në asnjë pjesë të tij nuk përmendet se kur është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” dhe ç’numër mban procedimi penal i regjistruar për të cilin prokurori ka vendosur marrjen e shtetasit A.Ç, si të pandehur dhe njoftimin e akuzës në ngarkim të tij.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me mangësitë e evidentuara në këto dokumente.

Analiza e Komisionit

Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe ato të dhëna në seancë dëgjimore, rezultojnë e provuar se të dyja mangësitë e analizuara nuk kanë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

44.3 Lidhur me dosjen nr. 4 rezultojnë se në përfundim të hetimeve për procedimin penal për veprën penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit Urim Buci, në datën 26.9.2016 ka kërkuar gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurës SH.T.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, datë 17.12.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurës për kryerjen e veprës penale “mashttrim në sigurime” dhe ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk u ushtrua ankim⁶². Në kërkesën e prokurorit për gjykim u konstatua se ajo nuk përmban subjektin të cilit i drejtohet, duke bërë që në mungesë të shkresës përcjellëse kjo kërkesë bëhet e paqartë. Sipas formularëve proceduralë standardë, duhej shënuar “drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”.

⁶² Referuar shënimeve të vendosura në ankim.

Analiza e Komisionit

Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe atyre të dhëna në seancë dëgjimore, rezulton e provuar se mangësia e analizuar nuk ka sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

44.4 Lidhur me dosjen nr. 5 rezulton se subjekti i rivlerësimit Urim Buci, në përfundim të hetimeve për procedimin penal për veprën penale “mashttrim në sigurime”, parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal, në datën 7.9.2016, ka kërkuar gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit B.D. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr. ***, datë 14.12.2016, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “mashttrim në sigurime” dhe ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi ndaj tij nuk u ushtrua ankim⁶³.

44.4.1 Edhe në këtë kërkesë të prokurorit për gjykim u konstatua se ajo nuk përmban subjektin të cilit i drejtohet duke bërë që në mungesë të shkresës përcjellëse kjo kërkesë bëhet e paqartë, pasi nuk kuptohet se kujt i drejtohet. Në kërkesën për gjykim në pjesën hyrëse të saj, sipas formularëve proceduralë standardë duhej shënuar “drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”.

44.4.2 Gjithashtu, u vërejt se ndonëse hetimet janë zhvilluar në mungesë dhe dërgimi i çështjes për gjykim është bërë në mungesë të të pandehurit B.H.D, duke kryer përfundimin e hetimeve me mbrojtës të caktuar kryesisht, ky fakt nuk del i lexueshëm në përmbajtjen e kërkesës për gjykim.

44.4.3 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuua të japë shpjegime në lidhje me mangësitë e evidentuara në këtë dokument.

Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe atyre të dhëna në seancë dëgjimore, rezulton e provuar se mangësitë e analizuar nuk kanë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

TË DHËNAT NGA BURIMET ARKIVORE

45. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk kanë rezultuar masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi. Subjekti për periudhën e rivlerësimit ka të arkivuara në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme vlerësimin e punës për vitin 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky vlerësim është “shumë mirë”. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta. Nuk ka të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të

⁶³ Referuar shënimeve të vendosura në ankim.

organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale). Nuk rezulton të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krimet e Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme.

46. Ndaj subjektit të rivlerësimit është paraqitur një ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme nga shtetasi E.K⁶⁴. Ankesa ka të bëjë me tre prokurorë, një ndër të cilët është subjekti i rivlerësimit Urim Buci. Pas verifikimeve përkatëse, Prokuroria e Përgjithshme e ka sqaruar ankuesin se çështja po shqyrtohet në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe është kjo gjykatë që do të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga prokurori. Gjithashtu, ka orientuar ankuesin që në lidhje me pretendimet e tij, nëse ka fakte që dëshmojnë konsumimin e elementeve të veprës penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve apo shpërdorim detyre, është e drejta e tij t'i paraqesë ato me shkrim në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit të tij gjyqësor. Ankuesi ka ngritur pretendime në mënyrë të paqartë për qëndrime të parregullta të prokurorëve (ndër të cilët është edhe subjekti Urim Buci), por pa specifikuar se ku konsistojnë këto parregullsi. Nga shqyrtimi i akteve bashkëlidhur ankesës u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁵ çështjen penale me objekt “kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 15.7.2016, në lidhje me pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. ***, viti 2015”. Në këtë çështje prokurori, në fund të shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar mospranimin e ankimit penal të paraqitur nga ankuesi.

47. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *Mospranimin e ankimit penal të paraqitur nga ana e ankuesve V.A dhe A.V, në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Për pushimin e pjesshëm të hetimeve, të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”.*

48. Sa më sipër, u konstatua se qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit/prokurori Urim Buci, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës është përkrahur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ç’ka tregon se ankesa e bërë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk gjen mbështetje.

49. Pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë paraqitur 6 ankesa për prokurorin Urim Buci⁶⁶, nga ankuesit D.K, P.LL, I.Ç, GJ.A⁶⁷, “R. Bank” dhe D.J. ILD-ja nuk përcolli informacion mbi statusin e këtyre ankesave apo mbi konkluzionin në të cilin ka arritur në lidhje me to. Komisioni kërkoi informacion nga ILD-ja mbi mënyrën se si ky institucion ka konkluduar⁶⁸ në lidhje me dy prej këtyre ankesave, depozituar nga ankuesit edhe pranë

⁶⁴ Ky rast është trajtuar edhe në pjesën “Denoncime”, pasi shtetasi E.K për këtë çështje ka bërë denoncim pranë Komisionit.

⁶⁵ Me vendimin nr. ***, datë 5.11.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori Urim Buci është caktuar në pozicion të përkohshëm të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (pa përcaktuar afatin për qëndrimin e tij në këtë pozicion).

⁶⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 9.3.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 10.3.2021).

⁶⁷ Dy prej ankesave (I.Ç dhe GJ.A) janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe kanë të bëjnë me një kallëzim për falsifikim dokumentesh. Ankuesi pretendon se ndaj dajës së tij L.GJ është bërë kallëzim penal për falsifikim dokumentesh shtetërore lidhur me pronësinë e një prone në ***, Vlorë. Sipas ankesës së tij, për këtë çështje janë bërë edhe dy herë më parë kallëzime penale ndaj L.GJ dhe prokurorët e mëparshëm kanë vendosur pushimin e procedimit penal dhe mosfillimin e procedimit penal, ndërsa prokurori Urim Buci vendosi ta çonte çështjen në gjykatë. Pas tij, çështjen e mori një prokuror tjetër. Ankuesja GJ.A është ankuar se prokurori e ka marrë atë të pandehur për veprën penale “falsifikim të dokumenteve nga personi që ka për detyrë ta lëshojë atë” dhe dokumenti për të cilin është akuzuar për falsifikim është aktekspertimi që ajo ka përgatitur për pronën e shtetasit L.G. Pretendon se aktekspertimi është bërë konform vendimit të gjykatës për këtë pronë (vendim civil), pasi kjo pronë ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Ankesat e shtetasve D.K dhe P.LL janë të përgjithshme, pa asgjë konkrete.

⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 30.11.2022.

Komisionit, të cilat janë trajtuar tek “Vlerësimi i denoncimeve nga publiku” (denoncues D.J dhe “R. Bank”). ILD-ja informoi se ka vendosur arkivimin e tyre, pasi ato nuk përmbushnin kriterin e pranueshmërisë⁶⁹.

GJETJE E KOMISIONIT LIDHUR ME RIVLERËSIMIN PROFESIONAL

50. Nga analizimi i të dhënave në sistemin TIMS rezultoi se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka udhëtuar 1 herë në vitin 2017 (ka dalë nga territori shqiptar nga pika kufitare *** në datën 2.3.2017, ora 13:45 dhe ka hyrë në territorin shqiptar po në datën 2.3.2017, ora 15:05, nga pika kufitare ***) me z. A.C. Udhëtimi është bërë me mjetin e z. A.H.C, me targë *** dhe në të ka qenë z. A.C dhe subjekti i rivlerësimit.

51. Nga hetimi i Komisionit⁷⁰ rezultoi se subjekti ka hetuar 2 kallëzime penale dhe një procedim penal, ku si subjekt i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë i përfshirë shtetasi A.H.C. Kallëzimet dhe procedimi penal janë si vijon:

51.1 Në vitin 2021 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 18.10.2021 për veprën penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal. Kallëzuesja, me detyrë përmbareuese gjyqësore, ka pretenduar se z. A.C, me detyrë *** ASHK-së Dibër, është bërë shkak për moszbatimin e titullit ekzekutiv.

51.2 Subjekti, në datën 3.11.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale. Ndaj vendimit të mosfillimit ka ushtruar ankim zyra përmbareuese dhe me vendimin nr. ***, datë 14.1.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka vendosur mospranimin e ankimit, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit. Dosja është përcjellë në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe deri në datën 8.2.2023 (data e kthimit të përgjigjes nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Dibër) nuk ka të dhëna mbi gjendjen e gjykimit të kësaj dosjeje në Gjykatën e Apelit⁷¹.

51.3 Në vitin 2022 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 17.3.2022, për veprat penale “shpërdorim detyre”, kryer në bashkëpunim dhe “korrupsion aktiv në zgjedhje”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248, 325 dhe 25 të Kodit Penal. Kallëzimi është bërë ndaj 49 shtetasve, një pjesë e të cilëve kryenin funksione shtetërore dhe një prej tyre ishte edhe z. A.C. Prokurori i çështjes Urim Buci, në datën 31.3.2022, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk përbën vepër penale.

51.4 Në datën 7.5.2021 është regjistruar procedimi penal nr. ***, pa autor, për veprat penale “heqja e paligjshme e lirisë” dhe “pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga nenet 110 dhe 293 të Kodit Penal. Procedimi është regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga Komisariati i Policisë Dibër, sipas kallëzimit penal të bërë në këtë komisarjat në datën 5.4.2021 nga shtetasi A.H.C. Nga hetimi rezulton se kjo çështje është ende në hetim nga subjekti i rivlerësimit.

51.5 Me qëllim hetimin sa më të plotë të kësaj çështjeje, në pyetësorin nr. 5, Komisioni pyeti edhe subjektin nëse ai gjatë kohës së ushtrimit të detyrës ka hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku ka qenë pjesëmarrës në çfarëdoqilindje, ndër të tjerë, z. A.H.C. Në

⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2022 (administruar në Komision me nr. ***, datë 9.12.2022).

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 1.3.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.3.2021) dhe shkresa nr. *** prot., datë 8.2.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 10.2.2023).

⁷¹ Shënim i vendosur në faqen e fundit të vendimit në fjalë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

përgjigje⁷², subjekti deklaroi që nuk ka hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku ka qenë i përfshirë në çfarëdolloj cilësie z. C.

51.6 Më pas, me *email*-in datë 10.2.2023, subjekti sqaroi Komisionin: *“Në vijim të pyetësorit nr. 5, sqaroj se pas verifikimit të kryer në zyrën e sekretarisë së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, vënë në dijeni sot në datën 10.2.2023, në lidhje me pikën nr. 8, sqaroj se unë, subjekti, gjatë ushtrimit të detyrës sime kam hetuar 2 kallëzime penale dhe 1 procedim penal, ku si subjekt i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë i përfshirë shtetasi A.H.C”* dhe ka sqaruar secilën prej çështjeve të hetuara, sipas shpjegimeve më lart.

51.7 Komisioni, me qëllim vërtetimin e situatës faktike të njohjes së subjektit me z. C, e ka pyetur⁷³ se cila është lidhja/njohja e tij me shtetasin A.C. Subjekti sqaroi: *“...shtetasi A.H.C ka qenë në një klasë me mua subjektin në gjimnazin e Peshkopisë në vitet 1992 – 1996. Me këtë shtetas nuk kam asnjë njohje/lidhje tjetër...”*.

51.8 Në përfundim të hetimeve, subjektit, sipas pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me vlerësimin e Komisionit se bazuar në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti duhet të hiqte dorë nga hetimi i këtyre çështjeve ku i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë z. A.C, si dhe lidhur me mospërputhjen e deklaramit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 5, me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

51.9 Subjekti depozitoi në Komision prapësime, ku parashtroi se nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për këto vendimmarrje, duke sqaruar se ka vendosur mbi bazën e provave dhe bindjes së tij të brendshme, si dhe shpjegoi: *“Nuk kam asnjë indicie për favorizimin e shtetasit A.C. Fakti që unë kam udhëtuar një herë rastësisht me këtë shtetas në vitin 2017, nuk njofton që kam qenë në kushtet e konfliktit të interesit, 4 vjet më vonë kur kam trajtuar këto kallëzime. Në atë periudhë, për shkak të rrugës së keqe në aksin Peshkopi-Tiranë, kam udhëtuar disa herë me kolegë nëpërmjet territorit të Maqedonisë së Veriut. Rasti i udhëtimit me automjetin e shtetasit A.C ka qenë i pari dhe i fundit. Rastet e heqjes dorë të prokurorit janë parashikuar në nenin 26, si dhe nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale. Asnjë nga këto dispozita nuk parashikon heqjen dorë apo përjashtimin e prokurorit nga trajtimi i materialeve për ish-shokët e klasës së mesme apo me personat që udhëton rastësisht”*.

51.10 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

51.11 Në lidhje me këtë çështje, gjatë seancës dëgjimore subjektit iu drejtuan pyetje nga anëtarët e trupit gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar.

51.11.1 Trupi gjykues e pyeti subjektin në lidhje me njohjen dhe marrëdhëniet e tij me z. C dhe nëse i vazhdon kontaktet me këtë shtetas.

51.11.2 Subjekti sqaroi përsëri se shtetasin A.C e ka njohur në vitet e gjimnazit, se e ka takuar rastësisht pas 20 vjetësh në vitin 2017 dhe se udhëtimi me të në këtë vit ka qenë rastësor. Sqaroi

⁷² Datë 27.1.2023.

⁷³ Pyetësor nr. 7.

se ka udhëtuar me të, duke e ditur që ai nuk ishte kontakt i papërshtatshëm që mund të cenonte figurën e tij. Subjekti shpjegoi gjithashtu se si prokuror në një qytet të vogël, ku njerëzit njihen me njëri-tjetrin, duke qenë për më tepër edhe vendi i tij i origjinës, ai nuk mund të heqë dorë nga çdo çështje ku janë të përfshirë persona thjesht të njohur.

51.11.3 Në lidhje me pyetjen nëse i vazhdon kontaktet me këtë person, subjekti sqaroi se nuk i vazhdon dhe se, me sa ka dijeni, ai është larguar nga Dibra dhe ushtron një funksion në Tiranë.

51.11.4 Vëzhguesi ndërkombëtar i kërkoi subjektit të specifikonte udhëtimin rastësor me z. C, i cili shpjegoi: *“Gjatë asaj periudhe aksi rrugor ka qenë në një gjendje shumë të rëndë, aksi Tiranë-Burrel-Peshkopi. Me mbarimin e orarit zyrtar të punës e kam takuar rastësisht, ka kaluar sepse është rruga kryesore që kalon për të shkuar në Tiranë ku unë banoj. Atë ditë ka rastisur që kolegët e mi nuk kanë qenë me mua..., e kam takuar e rastësisht sa kam zbritur shkallët e objektit, më ka thënë që unë jam për Tiranë, do të vish edhe ti me mua, unë kam pranuar dhe kemi bërë rrugën bashkë, dhe kjo ka qenë e gjitha”.*

51.12 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë hetimit dhe në seancë dëgjimore, çmon se:

- Subjekti i rivlerësimit ka pasur njohje me shtetasin A.C, njohje këto qoftë për faktin që kanë qenë në një shkollë bashkë, ashtu edhe për fakte të njohura botërisht lidhur me funksionet që ky shtetas ka kryer në një qytet të vogël siç është Peshkopia, apo faktin e pakundërshtueshëm që nuk mund të udhëtosh me automjetet me një person të panjohur. Shkalla e njohjes është e qartë, pasi subjekti deklaroi që nga takimi rastësor, sipas tij, udhëtoi me automjetin e këtij shtetasi.
- Me qëllim ruajtjen e parimit të paanshmërisë dhe hetimin e gjithanshëm e të plotë të çështjeve penale nga ana e subjektit, ky i fundit duhet të hiqte dorë nga hetimi i tyre.
- Nga ana tjetër, njohja me z. C provohet edhe me faktin që subjekti ka qenë kontradiktor në pohimet që i ka bërë Komisionit, si dhe nga fakti tjetër që njëra prej çështjeve është ende në hetim prej tij.

51.13 Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se bazuar në germën “ë” të nenit 17 dhe nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në pikën 1 të nenit 3, pikën 1/ii të nenit 4, germat “dh”/”v” të pikës 1 të nenit 5, si dhe në nenin 37 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, për kallëzimin penal nr. *** dhe për kallëzimin penal nr. ***, duhet të vërë në lëvizje Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për shqyrtimin e tyre, në kuadër të ushtrimit të detyrës në kushtet e konfliktit të interesit.

51.14 Në lidhje me procedimin penal nr. ***, trupi gjykues vlerësoi se meqenëse kjo çështje është ende nën hetim, bazuar në pikën 2 të nenit E të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo nuk mund të jetë objekt shqyrtimi nga Komisioni. Trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili me vendimin nr. 33/2021 (s. r. N.T), ka arsyetuar se: *“Ndalimi i vlerësimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, sipas 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ka synuar shmangien e paragjyqimit të organeve të rivlerësimit ndaj zgjidhjes së një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit e njëkohësisht dhe shmangien e paragjyqimit të çështjes e dhënies së*

zgjdhjeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit, nën 'presionin' apo ndikimin e procesit të rivlerësimit”.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

52. Në përfundim, pas verifikimit dhe analizimit në mënyrë të pavarur të tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, trupi gjykues vlerësoi se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

DENONCIME

53. Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar pranë Komisionit 9 denoncime. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, trupi gjykues administroi dosjet penale, shqyrtoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

53.1 Denoncim nr. *, datë 22.2.2018, i shtetasit E.K**

Denoncimi ka të bëjë me disa subjekte, ndër të cilët është edhe subjekti i rivlerësimit Urim Buci. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dalë në mbrojtje të personave të cilët denoncuesi i ka kallëzuar për falsifikim të një prokure. Denoncimin e ka shoqëruar me një sërë dokumentesh⁷⁴.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur denoncimit rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi A.V ndaj shtetasit L.B, ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2015, për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Kallëzuesi ka pretenduar se nëpërmjet falsifikimit të nënshkrimit të tij dhe nënës së tij në prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008, shtetasi L.B ka shitur tek persona të tjerë pronën, e cila është njohur me vendim të ZRKKP-së Vlorë.

Gjithashtu, rezulton se kjo prokurori, mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi V.A, ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2016, për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, me pretendimin se i është falsifikuar nënshkrimi i tij si person i besuar i shtetasës K.B në prokurën e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008, e legalizuar pranë noterit A.XH, në deklaratën noteriale nr. ***, datë 12.9.2009, si dhe në kontratën e ndërmjetësimit nr. ***, datë 12.9.2009, lidhur para noteres M.SH.

Prokurori i çështjes (që është një subjekt tjetër rivlerësimi, jo z. Urim Buci) ka vendosur bashkimin e dy procedimeve në një procedim të vetëm, me nr. *** të vitit 2015, duke vijuar më tej hetimet, në kuadër të këtij procedimi penal.

Në përfundim të hetimeve, prokurori i çështjes (jo z. Urim Buci), me vendimin datë 15.7.2016 ka vendosur: *Të pushojë hetimet për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga*

⁷⁴ Procesverbal për marrjen e dokumenteve; fletë nga media elektronike; vendim nr. ***, datë 26.10.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008; procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale; shkresë për dërgimin dhe njohjen me kopjen e vendimit të prokurorit për pushimin e pjeshëm të hetimeve, drejtuar shtetasit A.V, së bashku me vendimin në fjalë; vendim nr. ***, datë 21.12.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; urdhra të gjykatës për kërkimin dhe njoftimin e shtetasve L.B dhe E.B; procesverbal seance gjyqësore, datë 14.9.2017; procesverbale të seancave gjyqësore, etj.

neni 186 i Kodit Penal, regjistruar në kuadër të procedimit penal nr. ***, në lidhje me dokumentin “prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 15.12.2008”.

Ndaj vendimit të pushimit të hetimeve është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2017, ka vendosur: *Mospranimin e ankimit penal të paraqitur nga ana e ankuesve... në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë “Për pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015”.*

Prokurori që ka vendosur pushimin e hetimeve është një tjetër subjekt rivlerësimi⁷⁵, jo z. Urim Buci.

Nga procesverbalet e seancave gjyqësore bashkëlidhur denoncimit, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfaqësuar në gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁶ çështjen penale, me objekt “kundërshtim i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, datë 15.7.2016, në lidhje me pushimin e pjesshëm të hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2015”. Fillimisht përfaqësues ka qenë prokurori që ka kryer hetimet dhe ka vendosur pushimin dhe më pas ka qenë përfaqësues i prokurorisë subjekti Urim Buci. Në këtë çështje, prokurori, në fund të shqyrtimit gjyqësor, ka kërkuar mospranimin e ankimit penal të paraqitur nga ankuesi.

Ndaj vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 6.6.2018, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 21.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Shfuqizimin e vendimit të datës 15.6.2016 dhe vazhdimin e hetimeve.*

Nga raporti analizues i vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit⁷⁷, rezulton se për çështjen në fjalë denoncuesi E.K ka depozituar ankim edhe në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 23.2.2018, e cila, sikurse u trajtua më lart, e ka sqaruar z. K se çështja po shqyrtohet në Gjykatën e Apelit dhe se është kjo gjykatë e cila do të shqyrtojë dhe vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga gjykatat, si dhe e ka orientuar z. K që nëse ka fakte të cilat dëshmojnë konsumimin e elementeve të veprës penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve apo shpërdorim detyre nga ana e zyrtarëve të këtij institucioni, t’i paraqesë ato me shkrim në prokurorinë pranë gjykatës së rrethit të tij gjyqësor⁷⁸.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, konstatoi se veprimet hetimore që janë quajtur të paplota nga Gjykata e Apelit Vlorë nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit (ky i fundit ka qenë përfaqësues i prokurorisë gjatë procesit gjyqësor me objekt “kundërshtimi i vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë). Rrjedhimisht, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e ngritura nga denoncuesi në lidhje me subjektin e rivlerësimit janë të pabazuara.

⁷⁵ Prokurori E.M.

⁷⁶ Nga raporti analizues i vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, rezulton se me vendimin nr. ***, datë 5.11.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti është caktuar në pozicion të përkohshëm të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (pa përcaktuar afatin për qëndrimin e tij në këtë pozicion).

⁷⁷ Shihni faqen 31 të raportit.

⁷⁸ Kjo ankesë është trajtuar tek pjesa e raportit profesional.

53.2 Denoncim nr.*** prot., datë 17.2.2020, i shtetases D.J

Denoncuesja është nëna e viktimës K.J, vlarë në qytetin e Laçit në prill të vitit 2019, së bashku me kushëririn e tij E.J. Ajo ka paraqitur denoncim ndaj 3 subjekteve të rivlerësimit, një prej të cilëve është prokurori Urim Buci, duke pretenduar se nga ana e prokurorëve të çështjes, prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, janë kryer një sërë shkeljesh.

Denoncuesja pretendon se nga ana e organit të akuzës dhe të gjyqtarit të seancës paraprake nuk është përcaktuar saktë pozita procedurale e familjarëve të viktimave, duke iu mohuar në këtë mënyrë një sërë të drejtash. Konkretisht, pretendon se bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale⁷⁹ dhe në nenin 35 të udhëzimit nr. 5, datë 26.10.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm⁸⁰, familjarët e viktimave duhet të kishin pozitën procedurale të viktimave të veprës penale dhe, rrjedhimisht, të kishin të drejtat e viktimës së veprës penale, përcaktuar nga neni 58 i Kodit të Procedurës Penale, ndërkohë që organi i akuzës dhe gjyqtari i seancës paraprake i ka legjitimuar si trashëgimtarë të viktimës dhe jo si viktimë⁸¹.

Ajo ka ngritur pretendimin se hetimet kanë qenë të paplota dhe se prokuroria ka kryer manovra për të ndryshuar akuzën, duke u shprehur hapur se: “...do t’i nxjerrim nga burgu sepse nuk ka prova”. Pretendon se nuk janë marrë kamerat e ambienteve përreth dhe të lokalit ku ka nisur debati, se grupi i ekspertimit në vendngjarje atë natë nuk ka marrë prova që zbardhin të vërtetën

⁷⁹ Viktimë e veprës penale ka të drejtë: (a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; (b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale; (c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar; (ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjisllacionit në fuqi; (d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor; (dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues; (e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; (ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; (f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen; (g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal; (gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesëpadisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale; (h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore; (i) të dëgjohet nga gjykata edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar; (j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

⁸⁰ 1) Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, me “viktimë” kuptohet individi që ka pësuar dëm, përfshirë dëm fizik, emocional ose humbje ekonomike, për shkak të veprimeve ose mosveprimeve, kryerja e të cilave përbën veprë penale, pavarësisht nëse autori i veprës penale identifikohet, arrestohet, ndiqet penalisht apo dënohet dhe pavarësisht nga lidhjet e gjakut apo të krushqisë mes tij dhe autorit të veprës. 2) Në rastin e individit të vlarë si pasojë e një veprë penale, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, me “viktimë” kuptohet anëtar i familjes së tij, i cili ka pësuar dëm për shkak të vdekjes. “Anëtar i familjes ” është: (a) prindi dhe fëmija; (b) bashkëshorti ose ai që bashkëjetonte me të në kohën e vdekjes; (c) motra dhe vëllai; (ç) personi në ngarkim të tij, nga pikëpamja financiare.

⁸¹ Neni 35, pikat 3 dhe 4 të udhëzimit nr. 5, datë 26.10.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm: 3) “Trashëgimtar i viktimës” është trashëgimtari ligjor ose testamentar me titull universal, në kuptim të Kodit Civil, përveç personave të listuar në paragrafin 2 të këtij neni, sepse këta të fundit paraqiten drejtpërdrejt si viktimë. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor. 4) Trashëgimtari i viktimës gëzon vetëm këto të drejta: (a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit; (b) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod; (c) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit; (ç) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen; (d) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal.

dhe se prokuroria ka bërë shkelje të shumta procedurale, duke mos marrë në konsideratë të drejtat e viktimave dhe familjarëve të tyre.

Denoncuesja ka parashtruar një sërë shpjegimesh mbi dinamikën e ngjarjes, si dhe shpjegime të aspektit kriminalistik, për të mbështetur pretendimet e saj se janë manipuluar provat ose një pjesë e provave dhe e fakteve nuk janë marrë në konsideratë. Ajo pretendon se përfundimi i organit të akuzës është i gabuar, si për sa i përket ekzekutorit të dy viktimave, ashtu edhe për sa i përket kualifikimit ligjor të faktit penal. Pretendon se në konfliktin ku kanë qenë të përfshirë disa persona, ekzekutori nuk ka qenë shtetasi M.B, i cili ka pranuar autorësinë dhe është marrë si i pandehur, por ka qenë vëllai i tij, ndërsa shtetasit M dhe V.B, të cilët janë marrë si të pandehur, kanë qenë ndihmës.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin⁸², rezultoi se:

- Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin nr. ***, datë 7.1.2020, ka vendosur: *Dërgimin për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin të procedimit penal nr. ***, datë 28.4.2019, me të pandehur: M.B, akuzuar për kryerjen e veprave penale “vrasje në rrethana të tjera cilësuese”, parashikuar nga neni 79, germa “dh” e Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, parashikuar nga neni 278/1 i Kodit Penal; M.B, akuzuar për kryerjen e veprës penale “veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal; dhe V.P (B), akuzuar për kryerjen e veprave penale “moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe “përkrahja e autorit të krimi”, parashikuar nga neni 302, fjalia e dytë e Kodit Penal.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur⁸³ deklarinimin fajtor të të pandehurit M.B për veprat penale si më lart dhe dënimin e tij me burgim të përjetshëm, dënim i cili do të kryhet në burg të sigurisë së lartë.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë⁸⁴, e cila nuk ka konstatuar shkelje procedurale. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë.

Shtetasja D.J ka depozituar ankim edhe pranë ILD-së, institucion i cili ka konkluduar se ankesa nuk përmbushte kriterin e pranueshmërisë dhe ka vendosur arkivimin e saj⁸⁵.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pasi analizoi sa më lart, konstatoi se kjo çështje i është nënshtruar kontrollit gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit, duke mos u konstatuar mangësi apo probleme në veprimet e prokurorit, që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

53.3 Denoncim nr. * prot., datë 10.6.2019, i shtetasit B.K**

Denoncuesi pretendon se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër është dërguar një material kallëzues lidhur me kryerjen e punimeve të ujësjellësit të qytetit të Peshkopisë në qershor të vitit 2016. Sipas denoncuesit, materiali është filluar nga prokurori T.D kundër firmës së shtetasit S.S “nga firma e të cilit janë vjedhur miliona euro gjoja për ndërtimin e këtij

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.11.2022).

⁸³ Me vendimin nr. ***, datë 11.3.2021.

⁸⁴ Vendim nr. ***, datë 4.10.2021.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2022).

ujësjiellësi” dhe këtë material të dërguar në prokurori e ka marrë ish-prokurori i rrethit Urim Buci, i cili ia ka dhënë për të kryer veprime një prokuroreje dhe OPGJ-së. Denoncuesi vijon shpjegimin se pasi janë kryer disa veprime hetimore sa për sy e faqe, është vendosur pushimi i çështjes dhe se ky pushim është vendosur në mënyrë korruptive nga këta punonjës nën ndikimin e prokurorit Urim Buci, i cili ushqehet, shërbehet dhe flinte në hotel “V” pa pagesë. Pretendon se subjekti Urim Buci ka fjetur në këtë hotel për më shumë se 2 vjet.

Nga regjistri i gjendjes civile nuk rezultoi shtetas me emrin S.S dhe Komisioni, pasi hetoi, arriti në konkluzionin se denoncuesi i referohet shtetasit M.S, administrator i shoqërisë “S.G” sh.p.k.

Për të hetuar mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me këtë shtetas, Komisioni hetoi nëse subjekti i rivlerësimit ka hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku ka qenë pjesëmarrës me çfarëdolloj statusi “S.G” sh.p.k. dhe/ose M.S e M.S (shoqëria, ortakut dhe administratori i shoqërisë)⁸⁶.

Gjithashtu, Komisioni pyeti subjektin⁸⁷ nëse ka njohje me shtetasit M.S dhe M.S dhe, nëse po, iu kërkua të shpjegojë rrethanat e njohjes dhe lidhjen me këta shtetas, si dhe nëse ka hetuar çështje ku pjesëmarrës në çfarëdolloj cilësie kanë qenë këta shtetas apo personi juridik “S.G” sh.p.k.

Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka hetuar dy kallëzime penale dhe një procedim penal, ku si subjekt i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë i përfshirë subjekti “S.G” sh.p.k. dhe shtetasi M.S.

Në përgjigje të pyetjes së Komisionit mbi njohjen e tij me shtetasit M.S dhe M.S, subjekti deklaroi se nuk ka asnjë lidhje shoqërore, miqësore apo fafëfisnie dhe se këta shtetas i njeh thjesht si qytetarë të Peshkopisë dhe që kanë një hotel-restorant në qytetin e Peshkopisë. Gjithashtu, sqaroi se ka hetuar dy kallëzime penale dhe një procedim penal me të kallëzuar dhe kallëzues përkatësisht personin juridik “S.G” sh.p.k. dhe shtetasin M.S.

Edhe pas marrjes së detyrës si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, subjekti ka deklaruar adresë të vetme banesën e tij në K. dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 (pyetja nr. 8), ka deklaruar shpenzimet për rrugën vajtje-ardhje për në Peshkopi dhe nuk ka deklaruar adresë banimi/qëndrimi në Peshkopi.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues vlerësoi se nuk u provua që subjekti ka qëndruar në hotelin në pronësi të shoqërisë “S” sh.p.k., për më tepër pa pagesë dhe nuk u provua se në hetimin e çështjeve ku ka qenë i përfshirë shtetasi M.S dhe shoqëria “S” sh.p.k. subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.

53.4 Denoncimet nr. * prot., datë 3.10.2019, nr. *** prot., datë 16.4.2019 dhe nr. *** prot., datë 13.3.2019, të shtetas XH.J**

Denoncimi ka të bëjë me disa subjekte rivlerësimi, një ndër të cilët prokurori Urim Buci. Nga dokumentacioni bashkëlidhur denoncimit rezulton se denoncuesja ka depozituar kallëzim penal në prokurori ndaj fqinjëve të saj, me pretendimin se depozitat e tyre në tarracë i kanë dëmtuar muret dhe mobiliet e banesës (se ata lajnë tapetet në tarracën e pallatit duke i shkaktuar

⁸⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2022.

⁸⁷ Pyetësori nr. 5.

lagështi, si dhe pretendon se i kanë prishur disa herë derën kryesore). Konflikti ka qenë objekt i një procesi gjyqësor civil⁸⁸, në përfundim të të cilit është lëshuar urdhërekzekutimi me objekt “1. Detyrimin e të paditurve... të pushojnë cenimin e pronësisë së paditëses duke hequr depozitat 1000 litërshe dhe bazamentin ku mbështeten këto depozita; 2. detyrimin e të paditurve... të shpërblejnë paditësen në vlerën... në mënyrë solidare; 3. detyrimin e të paditurve të riparojnë tarracën...”.

Gjatë ekzekutimit të titullit ekzekutiv, kreditorja (denoncuesja) ka pasur proces gjyqësor edhe me Zyrën Përmbartimore, për shkak se kjo e fundit ka vendosur pushimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit. Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë disponuar për anulimin e këtij vendimi të Zyrës Përmbartimore dhe kanë vijuar procedurat e përmbartimit.

Në vijim, përveçse ndaj fqinjëve dhe përmbartuesit që duhet të ekzekutojë vendimin e gjykatës, nga ana e denoncueses ka pasur një sërë kallëzimesh penale ndaj prokurorëve që kanë trajtuar kallëzimet penale, ndaj gjyqtarëve që kanë lënë në fuqi vendimet e prokurorëve, ndaj kancelarit të gjykatës, avokatëve, etj.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga vetë denoncuesja dhe nga informacioni e dokumentacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin⁸⁹ rezulton se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka trajtuar disa kallëzime penale të bëra nga ana e shtetasës XH.J dhe ka disponuar me vendime mosfillimi, konkretisht, kallëzimet: nr. ***, datë 16.1.2019; nr. ***, datë 6.12.2018; nr. ***, datë 25.6.2019; nr. ***, datë 19.01.2019; dhe nr. ***, datë 25.2.2019.

Sipas informacionit të dërguar me shkresën në fjalë, nga verifikimet në gjykatë rezulton se ndaj vendimeve të mosfillimit për kallëzimet nr. *** dhe nr. *** është ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, e cila me vendimmarrje respektive ka rrëzuar ankesën e kallëzueses.

Në lidhje me kallëzimin penal nr. ***, datë 6.12.2018, me të cilin denoncuesja ka kallëzuar: (i) kancelarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me pretendimin se ai nuk ka dërguar në Gjykatën e Apelit dosjet në lidhje me dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ndaj të cilëve ajo kishte ushtruar ankim; si dhe (ii) avokatët e saj, të caktuar kryesisht – subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin:

- Nga aktet e administruara rezulton se në tri çështjet e pretenduara nga ana e kallëzueses, Zyra e Kancelarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ka përcjellë me shkresë dosjet përkatëse në Gjykatën e Apelit, duke referuar edhe shkresat përkatëse.
- Nga procesverbalet e seancave gjyqësore rezulton se shtetasja XH.J është mbrojtur vazhdimisht nga avokatët e Zyrës së Avokaturës së Shtetit, z. G.R, z. M.L dhe z. E.B, të cilët janë paraqitur për të realizuar mbrojtjen në gjykatë, por pa përjashtuar impenjimet e tjera që ka pasur si zyrë.

Në lidhje me kallëzimet nr. ***, datë 16.1.2019 dhe nr. ***, datë 25.6.2019, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se faktet objekt kallëzimi kanë qenë objekt hetimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe ka pasur një vendimmarrje nga ana e kësaj të fundit. Ai ka arsyetuar se kallëzuesi nuk mund të investojë

⁸⁸ Vendim nr. ***, datë 30.3.2010, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

⁸⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 21.11.2022).

prokurorinë të fillojë një procedim penal për të njëjtën vepër penale, për të njëjtin fakt penal dhe ndaj të njëjtëve persona të kallëzuar, që prokuroria është shprehur më parë me vendimmarrje.

Vlerësimi i Komisionit

Pas shqyrtimit të fashikujve të administruar në lidhje me çështjet e hetuara nga subjekti si më lart, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e ngritura nga denoncuesja në lidhje me subjektin e rivlerësimit janë të pabazuara.

53.5 Denoncim nr. * prot., datë 10.5.2019, i “R. Bank”**

Denoncuesi shpjegon se ka lidhur një kontratë kredie me shoqërinë “V” sh.p.k. dhe dorëzanës A.G. Gjithashtu, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve, midis “R. Bank” dhe shtetasit A.G është lidhur një kontratë kredie, një kontratë pengu dhe një kontratë për kalimin e disa marrëveshjeve. Fillimisht marrëdhënia midis palëve ka qenë korrekte konform kushteve të kontratave, por në vitin 2017 kredimarrësi “V” sh.p.k. dhe garantuesi nuk kanë shlyer më detyrimet kundrejt kreditorit “R. Bank”. Në këto kushte, kjo e fundit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kontratën e kredisë. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Përmbaruesi i kontraktuar nga “R. Bank” për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimit ka bërë njoftimin për ekzekutim vullnetar dhe meqenëse nga ana e palës debitore nuk është ndërmarrë asnjë veprim për shlyerjen e detyrimit në mënyrë vullnetare, ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm; përmbaruesi ka nxjerrë urdhër për vënien e sekuestros konservative dhe ka urdhëruar: të gjitha bankat e nivelit të dytë për t’i vënë sekuestro debitorit në llogaritë e tij deri në masën e shlyerjes së detyrimit të përcaktuar në titullin ekzekutiv⁹⁰; Qendrën Kombëtare të Biznesit të bllokojë veprimet për ndryshime që debitori mund të bëjë; sekuestro pranë ARRSH-së për të gjitha automjetet e regjistruara në emër të debitorit; sekuestro në ZVRPP-në Kurbin për të gjitha pasuritë e regjistruara pranë kësaj zyre në emër të debitorit.

Gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore, debitori ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ankim “kundërshtim i veprimeve përmbarimore”, duke kërkuar edhe pezullim të veprimeve përmbarimore, por kjo kërkesë deri në datën e paraqitjes së denoncimit në Komision ende nuk ishte shqyrtuar (referuar parashtrimin në denoncim).

Gjithashtu, gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore, debitori ka paraqitur edhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin padi për “pavlefshmëri titulli ekzekutiv” ndaj kreditorit “R. Bank” dhe përmbaruesit, duke kërkuar sërish pezullimin e veprimeve përmbarimore. Në datën 2.5.2019 gjykata ka rrëzuar kërkesën për pezullim të veprimeve përmbarimore.

Krahas dy padive të ngritura në gjykata të ndryshme, debitori “V” ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin një kallëzim penal, duke pretenduar konsumim të veprave penale nga “R. Bank” dhe shoqëria përmbarimore. Prokurori i ngarkuar me hetimin në lidhje me këtë kallëzim penal është subjekti i rivlerësimit Urim Buci, i cili sipas pretendimit të denoncuesit në *paligjshmëri të plotë dhe me dyshime të forta dhe të arsyeshme korrupsioni, ka urdhëruar në datën 3.5.2019, menjëherë pasi gjykata ka rrëzuar masën për pezullimin e veprimeve përmbarimore, sekuestrimin e dosjes origjinale të përmbarueses, duke vendosur*

⁹⁰ Në masën 3,817,894.98 euro.

kështu efektivisht pezullimin e ekzekutimit të një urdhri ekzekutimi të dhënë nga një gjykatë kompetente për ekzekutimin e një kredie bankare.

Denoncuesi pretendon se prokurori ka shkelur përcaktimet ligjore në lidhje me kompetencën tokësore të prokurorisë, të përcaktuara në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale⁹¹, pasi, sa i përket kësaj kompetence, *në majën e hierarkisë qëndron prokuroria ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja, në radhë të dytë qëndron vendqëndrimi ose vendbanimi i të pandehurit dhe në radhë të fundit qëndron prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale.* Denoncuesi vijon arsyetimin se në rastin në fjalë, po të prezumohet se vepra penale e mashtrimit është kryer nga përmbaruesja, kjo e fundit detyrën e ushtron në Tiranë pranë selisë së saj dhe nëse do prezumohej që “R. Bank” e ka kryer veprën penale të mashtrimit lidhur me urdhrin e ekzekutimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vepra penale sërish do të ishte kryer në Tiranë, vendi ku ka dalë urdhri i ekzekutimit.

Bazuar në sa më lart, denoncuesi pretendon se në rastin në fjalë prokuroria që ka kompetencën tokësore për trajtimin e kallëzimit është Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe jo Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, prandaj, në referim të nenit 84 të Kodit të Procedurës Penale⁹², prokurori duhet të konstatojë moskompetencën e vet dhe të vendoste dërgimin e akteve.

Gjithashtu, denoncuesi pretendon se vendimi i subjektit të rivlerësimit është i paarsyetuar, duke qenë kështu në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të një procesi të rregullt ligjor parashikuar në nenet 42 e 142/1 i Kushtetutës⁹³ dhe nenin 6 të KEDNJ-së⁹⁴.

Në përfundim, denoncuesi pretendon se shkak i vërtetë i vendimit për sekuestrimin e dosjes përmbarimore është pengimi i veprimeve të përmbaruesit privat dhe pezullimi i ekzekutimit të një titulli ekzekutiv kredi bankare me mjete të jashtëligjshme, duke i sjellë debitorit “V” sh.p.k. përfitime materiale dhe jomateriale dhe duke dëmtuar interesat e ligjshme të “R. Bank”.

⁹¹ “1. Kompetenca tokësore përcaktohet, me radhë, nga vendi ku është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale ose vendi ku ka ardhur pasoja. 2. Në qoftë se vendi i treguar në paragrafin 1 nuk dihet, kompetenca i përket, me radhë, gjykatës së vendqëndrimit ose të vendbanimit të të pandehurit. 3. Në qoftë se as kështu nuk mund të përcaktohet kompetenca, kjo i përket gjykatës së vendit ku ndodhet prokuroria që ka regjistruar e para veprën penale. 4. Rregullat e caktuara në paragrafët e mësipërm zbatohen edhe gjatë hetimit paraprak”.

⁹² “1. Kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton moskompetencën e vet për çdo lloj shkak vëndos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente. 2. Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate”.

⁹³ Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Neni 142/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara”.

⁹⁴ “1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

Nga aktet dhe informacioni i vendosur në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin⁹⁵ në lidhje me çështjen në fjalë, rezulton se:

Ndaj vendimit nr. *** prot., datë 3.5.2019, të prokurorit Urim Buci, për sekuestrimin e dosjes përmbaremore në fjalë⁹⁶, kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin ankuesit: shoqëria “R. Bank” dhe shoqëria përmbaremore “V” sh.p.k. Procedimi penal, për efekt të të cilit është vendosur sekuestrimi, është procedimi penal nr. ***, datë 23.4.2019, kallëzues “V” sh.p.k. ndaj “R. Bank” dhe shoqërisë përmbaremore “T.B” sh.p.k.

Kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 10.7.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit “Për kryerjen e sekuestrimit” të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me të cilin është vendosur sekuestrimi i dosjes përmbaremore nr. ***, datë 25.3.2019, pranë shoqërisë përmbaremore private “T.B” sh.p.k.⁹⁷.

Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim “R. Bank” dhe shoqëria përmbaremore “T.B” sh.p.k.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. *** akti/nr. *** vendimi, datë 18.11.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të sipërpërmendur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me këtë ndryshim: *“Detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin t’i kthejë origjinalin e urdhrin të ekzekutimit, vendimin nr. ***, datë 24.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pranë shoqërisë përmbaremore ‘T.B’ sh.p.k. dhe mbajtjen e kopjes së këtij dokumenti”*. Ndër të tjera, kjo gjykatë ka arsyetuar se sekuestrimi dhe mbajtja nga prokuroria e origjinalit të urdhrin të ekzekutimit, i cili lëshohet vetëm në një kopje të vetme, passjell pezullimin e ekzekutimit dhe se ky urdhërekzekutimi nuk përbën provë materiale që shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara.

“R. Bank” ka depozituar ankim edhe pranë ILD-së dhe ky institucion ka konkluduar se ankesa nuk përmbushte kriterin e pranueshmërisë dhe ka vendosur arkivimin e saj⁹⁸.

Trupi gjykues konstatoi se kjo çështje i është nënshtruar kontrollit gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit, duke mos u konstatuar probleme në lidhje me kompetencën tokësore dhe në lidhje me faktin e sekuestrimit të dokumentacionit, si një e drejtë e prokurorit me qëllimin kryerjen e

⁹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 25.11.2022).

⁹⁶ Dosja përmbaremore nr. ***, datë 25.03.2019, regjistruar në referim të urdhrin të ekzekutimit nr. ***akti, datë 24.2.2017, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me titullin ekzekutiv “kontratë kredie me kufij nr. ***, datë 20.10.2014” (e ndryshuar).

⁹⁷ Në këtë vendim, gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“Së pari, ...vendimi i prokurorisë për sekuestrim në kuadrin e një procedimi penal të regjistruar prej saj, është një veprim hetimor që ia lejon ligji në kuadrin e ushtrimit të ndjekjes penale. Së dyti, dokumentet e sekuestruara, konkretisht dosja përmbaremore, mbahet nga ana e prokurorisë për qëllim prove, pra për vërtetimin e fakteve që lidhen me veprat penale ‘mashtim’ dhe ‘shpërdorim detyre’. Gjykata çmon se këto dokumente janë provat e vetme mbi bazën e së cilës prokuroria mund të hetojë lidhur me veprat penale për të cilat ka regjistruar procedimin penal. Gjykata çmon se është në diskrecionin e prokurorisë që të vendosë sekuestro mbi dokumentacionin origjinal, sikurse është vepruar në rastin konkret... Gjykata, në rastin konkret, shqyrton ligjshmërinë e vendimit të sekuestrimit në momentin që ai është marrë nga prokuroria. Në rastin konkret, ekzistojnë në mënyrë kumulative kushtet për vendosjen e sekuestrimit sipas neneve 187 dhe 208 të Kodit të Procedurës Penale. ...ankuesit... kanë të drejtë t’i drejtohen prokurorit të çështjes me kërkesë me shkrim ku t’i kërkojnë që të disponojë sipas nenit 213, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet shprehimisht: ‘1. Organi procedues mund të urdhërojë nxjerrjen e kopjeve të akteve dhe të dokumenteve të sekuestruara, duke kthyer origjinalet dhe kur origjinalet duhet të mbahen, urdhëron sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuar’. ...pra, ankuesit mund t’i kërkojnë prokurorisë që të urdhërojë nxjerrjen e kopjeve të dokumenteve të sekuestruara, duke i kthyer origjinalin atyre (ankuesve) dhe kur origjinalet duhet të mbahen, urdhëron sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuar”*.

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2022 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2022).

hetimeve, por duke detyruar prokurorinë t'i kthejë origjinalin shoqërisë përmbartimore dhe të mbajë kopjen e dokumentit.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi arsyen e sekuestrimit të dokumentacionit origjinal të dosjes përmbartimore, përkundrejt nxjerrjes së kopjes së tij.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti depozitoi në Komision prapësime, ku parashtroi se sekuestrimi i dokumenteve është bërë sipas nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale dhe se: *“Në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet qartë se prokurori ushtron ndjekjen penale dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që konsideron të nevojshëm. Në këtë rast, unë kam konsideruar të nevojshëm sekuestrimin e dokumenteve të dosjes përmbartimore për të shqyrtuar dhe këqyrrur edhe fizikisht dokumentet e dosjes përmbartimore në fjalë, me qëllim që të orientoja hetimet në përputhje me ligjin dhe për të zbardhur të vërtetën. Ju siguroj se nuk kam pasur asnjë qëllim tjetër përveçse të zbuloja të vërtetën dhe këtë veprim e kam menduar të nevojshëm. Sipas ligjit, ndaj vendimit të sekuestrimit të prokurorit ligji ka parashikuar të drejtën e ankimit për palën. Kjo e drejtë është ushtruar nga subjekti që janë sekuestruar dokumentet dhe Gjykata e Shkallës së Parë Kubin e ka gjetur të drejtë vendimin e prokurorit, çka tregon se vendimmarrja e prokurorit është vlerësuar edhe nga gjykata sipas ligjit”.*

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 25.4.2023, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmoi se, bazuar në nenin 24 të Kodit të Procedurës Civile, është e drejta e prokurorit që ushtron ndjekjen penale të kryejë vetë çdo veprim hetimor që konsideron të nevojshëm dhe sekuestrimi i dokumentacionit është veprim hetimor në diskrecionin e prokurorit, por trupi gjykues mban parasysh edhe disponimin e Gjykatës së Apelit Tiranë në vendimin e sipërcituar, e cila ka vendosur detyrimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin t'i kthejë origjinalin e urdhrin të ekzekutimit shoqërisë përmbartimore “T.B” sh.p.k. dhe të mbajë kopjen e këtij dokumenti. Gjithashtu, ndër të tjera, kjo gjykatë ka arsyetuar se sekuestrimi dhe mbajtja nga prokuroria e origjinalit të urdhrin të ekzekutimit, i cili lëshohet vetëm në një kopje të vetme, passjell pezullimin e ekzekutimit dhe se ky urdhërekzekutimi nuk përbën provë materiale që shërben për të vërtetuar faktet e pretenduara.

Pra, duke sekuestruar origjinalin e urdhrin të ekzekutimit, i cili sipas vlerësimit të gjykatës nuk përbënte provë materiale për vërtetimin e fakteve, subjekti ka pezulluar de facto ekzekutimin e tij.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se i parë në raport me vlerësimin tërësor të subjektit, ky rast nuk mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por sa i përket sekuestrimit të dokumentacionit origjinal, veprim i cili ka shkaktuar pasojën e mësipërme, trupi gjykues çmoi të transferojë pranë organit kompetent, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për inspektim këtë procedim penal të hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

53.6 Denoncim nr. * prot., datë 17.11.2017, i shtetasit I.B**

Denoncuesi ka shpjeguar se në vitin 2015 ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për veprat penale “falsifikim dokumentesh” dhe “pastrim të produkteve të veprës penale”, pasi është vënë në dijeni të faktit që objekt i këtyre veprave penale ishte bërë edhe një pasuri e paluajtshme tokë pyll dhe kullotë me vendndodhje në K, Vlorë, pasuri e cila ka qenë në bashkëpronësi të babait dhe xhaxhait të tij, të fituara nga këta të fundit me trashëgimi ligjore nga babai i tyre.

Denoncuesi pretendon se nga kjo prokurori janë çuar për t’u gjykuar jo fajtorët e vërtetë, por njerëzit që janë përdorur për të kryer këto veprime abuzive dhe se nuk janë çuar për t’u gjykuar persona të tjerë për të cilët nga hetimi kanë rezultuar veprime të paligjshme.

Bashkëlidhur denoncimit ka vendosur kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, “Për gjykimin e çështjes penale”⁹⁹, nga ku rezulton se hetimi i kësaj çështjeje është bërë nga dy prokurorë, njëri prej të cilëve është subjekti i rivlerësimit Urim Buci.

Në përfundim të hetimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017, në ngarkim të të pandehurve R.N, L.GJ, E.H, B.DH (B) dhe D.B.

Veprimtaria e prokurorit i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor dhe Komisioni administroi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Vlorë¹⁰⁰, nga të cilat rezultoi se gjykata nuk i ka konsideruar hetimet të paplota dhe nuk ka urdhëruar kryerje të hetimeve shtesë.

Vlerësimi i Komisionit

Bazuar në sa më lart, trupi gjykues konstatoi se kjo çështje i është nënshtuar kontrollit gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit, duke mos u konstatuar probleme në veprimet e prokurorit, që të kenë sjellë cenim të të drejtave të palëve në proces apo shkelje të rënda procedurale, të cilat mund të sjellin cenimin e procesit.

53.7 Denoncim nr. * prot., datë 2.2.2018, i shtetases V.T**

Denoncimi ka të bëjë me disa subjekte rivlerësimi, një prej të cilëve është subjekti i rivlerësimit Urim Buci, i cili në kohën kur referon denoncuesja ka qenë OPGJ.

Denoncuesja ka depozituar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2010 kallëzim penal për falsifikim dokumentesh. Prokuroria në fjalë, në datën 7.12.2010, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. *** të vitit 2010. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰¹ dhe ky i fundit është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë¹⁰².

Në këtë çështje subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka qenë Oficer i Policisë Gjyqësore dhe nuk ka disponuar me vendim.

Vlerësimi i Komisionit

⁹⁹ Kërkesë nr. *** prot., datë 21.7.2017.

¹⁰⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.11.2022).

¹⁰¹ Vendim nr. *** akti, datë 14.2.2011.

¹⁰² Vendim nr. ***, datë 28.10.2011.

Bazuar në sa më lart, trupi gjykues vlerësoi se denoncimi nuk ka të bëjë me veprime apo vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit, i cili në kohën e kryerjes së veprimeve objekt denoncimi, nuk kishte filluar detyrën e prokurorit.

53.8 Denoncim nr. * prot., datë 20.11.2018, i shtetas A.H dhe denoncim nr. *** prot., datë 16.5.2019, i shtetasit N.D**

Denoncimet nuk kanë asnjë të dhënë konkrete në lidhje me sa pretendohet dhe nga ana e Komisionit nuk u bë i mundur komunikimi me denoncuesit me qëllim marrjen e të dhënave konkrete sepse denoncuesit nuk kanë lënë asnjë mënyrë kontakti (nr. tel. apo adresë *email*/postare).

Vlerësimi i Komisionit

Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se nuk ka asnjë *indicie* konkrete për të hetuar më tej në lidhje me sa është pretenduar në këto denoncime.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Urim Buci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.
2. Në bazë të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, vendosi të transferojë pranë organit kompetent, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, për inspektim kallëzimin penal nr. ***, kallëzimin penal nr. *** dhe procedimin penal nr. **, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në

përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 27.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO

Kryesuese

Alma FASKAJ

Relatore

Xhensila PINE

Anëtare (kundër)

Sekretare gjyqësore

Albana Plaka